

**E VËRTETA E KRIJIMIT  
DHE EVOLUCIONI**



---

# E vërteta e krijimit dhe evolucioni

M. FETHULLAH GYLEN

---



© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese

# E VËRTETA E KRIJIMIT DHE EVOLUCIONI

**Titulli i origjinalit:**

**M.F. GÜLEN: YARATILIŞ GERÇEĞİ VE EVRİM**

Përktheu: Dr. Mithat HOXHA

Redaktoi: Klodian SHEHI

Design: Indrit ISUFI

ISBN: 978-99927-944-9-6

Shtëpia Botuese “PRIZMI”

Adresa: Rr. Kajo Karafili

P.Bimbashi, A.4, Tiranë

[www.prizmi.com](http://www.prizmi.com)

Shtypur në shtypshkronjën Emal, 2013

*Ky libër është përgatitur duke u mbështetur në bisedat  
mbi evolucionin të mbajtura nga autori para vitit 1980*

## PËRMBAJTJA

Hyrje	10
Evolucioni	16
Katër tezat kryesore ku mbështetet darvinizmi	18
Pretendimi evolucionist dhe ngjashmëritë mes gjallesave	19
Çështja e përdorimit dhe mospërdorimit të organeve dhe përshtatja	24
Evolucioni dhe etapat që kalon fetusi në mitër	27
Fosilet	33
Fosilet e zogjve	34
Legjenda e kalit pesëthundrak	35
Format iluzive të kalimit nga majmuni në njeri	37
Çështja e mutacionit	39
Pretendimi mbi pemën gjenealogjike dhe pema (gjenealogjike) e qenies	45
Seleksioni natyror ose përzgjedhja natyrore	48
Materia, rastësia dhe pretendimet e vetëkrijimit	52
A është e mundur rastësia dhe a mund të shpjegohet ekzistenca e saj?	56
Vetekzistenca	59
Eksperimentet e Milerit	59
Autotrof, heterotrof	60
Ekzistenca dhe ligjet e saj	61
Renditja e proteinave dhe aminoacideve	61
Ushqyerja dhe rritja	62
Një tjetër specifike shumë e rëndësishme që i mashtron darvinistët	63
Ekzistenca çift	64
Qeliza dhe veprimtaria qelizore	65
Një udhëtim i shkurtër në botën e jashtme dhe brenda vetes tonë	68
Krijimi në Kuran dhe në hadithet profetike	72

Karakteri mrekullor i Kuranit	72
E vërteta e krijimit në Kuran	74
Kuptimi i disa ajeteve të tjera kuranore që kanë lidhje me krijimin	76
Krijimi në hadithet profetike	76
Krijimi në Librin e Shenjtë	78
Përfundim	79





*Baza e këtij libri mbështetet në një pjesë bisedash në një kuadër shumë të ngushtë të fundit të viteve gjashtëdhjetë. Kurse bisedat e tipit të konferencës para një auditori më të gjerë i takojnë periudhës pas viteve shtatëdhjetë.*

*Ato ditë, dokumentet dhe literatura përkatëse e kësaj teme ishin papërfillshmërisht të pakta; duke iu shtuar kësaj, natyrisht, edhe pamjaftueshmëria ime, bëhet e qartë se ç'libër do të dilte në shesh.*

*Personalisht, unë kam menduar se sot, në një periudhë kur janë shkruar e shkruhen shumë gjëra serioze mbi çështjet që përbëjnë tematikën e këtij libri, nuk do të ishte i nevojshëm botimi i thërrimeve të tilla mendimesh e konsideratash të thëna e të shkruara dikur nxitur nga kërkesat e ditës, pa marrë parasysh pamjaftueshmërinë e tyre. Por, kur shokët e mi të idesë dhe rrugës së përbashkët, ndaj emrit dhe kujtimit të të cilëve qysh në krye të herës jam përpjekur të mbetem me respekt, i deshifruan, redaktuan dhe m'i vunë para ato biseda të vjetra, edhe unë, duke i vlerësuar ato vetëm si kujtime, thashë “po” për botimin e atyre dokumenteve të mia tejet modeste!*

*Ja, vetëm kaq!*

**Fethullah Gylen**

## HYRJE

Ekzistenca, jeta, bota e gjallesave dhe, veçanërisht, njeriu, mes këtyre, kanë shumë anë të ndryshme që përbëjnë bazë për shkencën të ndryshme. Kur e trajtojmë çështjen vetëm lidhur me njeriun, na dalin përballë morfologjia, fiziologjia, psikologjia, sociologjia, mjekësia, pedagogjia dhe një sërë shkencash të tjera. Secila prej këtyre përbën një tematikë të veçantë specialiteti dhe për çdo specialitet ka edhe specialistë përkatës. Por ç'është që nuk ka një specialist të të gjithë universitetit, të gjallesave, madje s'ka një specialist të njeriut. Për rrjedhojë, me këto shkencë të specializuara është e pamundur si zgjidhja e problemeve të ardhura bashkë me ekzistencën dhe njeriun, ashtu edhe, natyrisht, thënia e diçkaje përfundimtare mbi këto shkencë. Nga këto, është nevoja e një vetëdijeje kolektive dhe e qendrave shkencore krejt të përsosura të cilat, vetëm për ta kuptuar njeriun dhe nxjerrë në shesh teknologjinë njerëzore, të mund të prodhojnë njohuri gjithëkonceptuese, të parashetrojnë mendimin e përgjithshëm dhe sinteza të plota si dhe të mund ta përfshijnë epokën me të gjithë ekzistencën e saj. Pandeh se në vitet e ardhshme, lidhur me këtë temë, do të shkruhen shumë libra, do të parashtrihen mendime alternative të panumërta dhe, duke hyrë në veprim qendra shkencore të përmasave botërore, do ta ushqejnë edhe më shumë këtë këndvështrim. E pikërisht atëherë, një sërë njerëzish fatmirë të mendimit e shkencës do ta shkruajnë përsëpari ecurinë e ekzistencës, do ta zbulojnë përsëpari çdo gjë, veçanërisht gjallesat dhe, mes tyre, njeriun dhe, duke i nxjerrë në shesh të vërtetat e gjerësisë së njeriut, do të mund të thonë gjëra më të qarta mbi çështjet që përbëjnë bazat e shkencave.

Megjithëkëtë, mund të themi se sot, në laboratorët moderne,

i është hyrë analizës dhe njohjes së gjallesave në një mënyrë që s'ka qenë e mundur të arrihet gjer më sot. Lënda, molekula dhe qeliza janë bërë, në një masë të madhe, të njohshme e të dukshme pothuaj me të gjitha aspektet e tyre; në sajë të rrezeve X, është ekspozuar para syve forma dhe struktura e copëzave më të vogla të hyra në strukturën e lëngjeve dhe qelizave të trupit; në disa laboratorë moderne dhe qendra kërkimore-studimore, janë sjellë në një masë të caktuar në gjendje të kuptueshme makropjesët përbërëse të proteinave që i përkasin një niveli më të lartë se përbërjet inorganike, funksionet e enzimave që i ndajnë dhe i bashkojnë këto, ligjet e marrëdhënieve të qelizave dhe indeve të përbëra prej tyre me mjedisin e brendshëm; lëngje të tilla si gjaku dhe tëmthi dhe marrëdhëniet e tyre me mjedisin kozmik, lidhjet e elementeve kimike me trupin dhe vetëdijen, të gjitha këto konsiderohet se janë qartësuar e kuptuar qoftë edhe relativisht.

Me gjithë këto zhvillime shkencore të denja për t'u vlerësuar, është e vështirë të thuhet se, veçanërisht në Turqinë pas Tanzimatit e gjer më sot, si në çdo fushë, edhe në katedrat dhe çerdhet shkencore, të jenë përjetuar të njëjtat zhvillime. Kjo periudhë në të cilën vendin e kërkimit, analizës dhe ndriçimit shkencor e zuri një imitim i verbër dhe vendin e mendimit shkencor, një shabllonizëm me çmim të lirë, do të kujtohet gjithë me keqardhje nga brezat e ardhshëm. Në këtë periudhë, ekzistenca u paraqit dhe u përshkrua pothuajse si një kaos, materia u pranua si copëra gjërash të hedhura dhe përplasma andej-këtej nga erërat e rastësisë, gjallesat u panë si një kafshatë e zakonshme që përtypej nën dhëmbët e pamëshirshëm të "seleksionit natyror", kurse njeriu u poshtërua duke u vënë në rolin e një spektatori të pafat të ulur në tribunat e kësaj arene vdekjeje; e një spektatori të pafat, të dënuar për t'i soditur, dëgjuar dhe përjetuar të gjitha këto... Kurse, po të shihet nga një këndvështrim tjetër, do të kuptohet se e vërteta qëndron ndryshe, se mes të gjithë elementëve dhe të gjitha pjesëve të ekzistencës ka ndihmë reciproke dhe solidaritet, se gjithçka zhvillohet në rregullsi dhe harmoni të plotë, se "gjithçka është planifikuar sipas një qëllimi dhe synimi përfundimtar të caktuar"

dhe se çdo gjë, e ekspozuar si një libër i shpalosur, karakterizohet nga një përmbajtje dhe cilësi marramendëse!

Unë nuk jam në gjendje ta gjykoj këtë këndvështrim të gabuar të ditëve të sotme dhe as t'i hulumtoj shkaqet e këtij shtrembërimi. Ndërkaq, është e dobishme që t'i theksojmë disa gjëra. Së pari, që një kohë kur laboratorët tanë u shterpëzuan në atë mënyrë dhe u lidhën pas një orbite të vetme të tillë që, për fat të keq, qendrat tona kërkimore-shkencore si dhe sistemi ynë arsimor, në vend të shkencëtarëve dhe mendimtarëve të rangjeve botërore, përgatitën teknokratë që nuk qenë në gjendje t'u jepnin përgjigje pyetjeve “kush”, “si”, “pse” dhe “përse” që qëndronin me kokëfortësi para çdo dukurie!

Me të vërtetë, sa shkencëtarë përgatitëm ne që të mundnin të nxirrnin në dukje lajthitjet e shkencëtarëve perëndimorë, të kishin guximin që, duke përcaktuar, bie fjala, aspektet e mangëta, të gabuara e të shtrembëruara të darvinizmit, të thoshin se, sikurse teoritë e tjera, edhe darvinizmi mund të vihej në dyshim dhe diskutim si dhe të ripërtëritnin konsideratën se njeriu është, në thelb, një “qenie e nderuar, sublime” dhe jo groteske? Pra, sa qenë në gjendje të interpretonin ata se, krahas syve, trurit, hundës, veshëve, sistemeve të metabolizëm-katabolizmit, qarkullimit, frymëmarrjes, etj., që ekzistonin edhe te kafshët, njeriu zotëronte në mënyrë të privilegjuar aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me qeniet e tjera, aftësinë për të zbuluar “anën tjetër” të gjërave dhe për të krijuar vlera si dhe, në përgjithësi, ta interpretonin njeriun në mjedisin e tij e të varur nga ai mjedis? Jo vetëm këto s'u bënë, por shkenca u shndërrua veçanërisht në një tabu të kundërvënë ndaj besimit dhe fesë, u sakrifikua për hir të këndvështrimeve dhe konsideratave ideologjike dhe nuk doli dot jashtë kufijve të pozitivizmit vulgar të shek. XIX, madje as të materializmit naiv!

Sa e hidhur është që, si rezultat i kësaj, biologjia na paraqitet sot si një fantazi e ngritur mbi teori të pavërtetuara, në krye të të cilave qëndron, pa asnjë dyshim, teoria e evolucionit! Ç'është e vërteta, nuk është puna ime ose e njerëzve si unë që merremi me

një fushë tjetër, të flasim e shkruajmë për evolucionin, mirëpo kjo do të vazhdojë të bëhet për hir të së vërtetës gjersa të vijë dita që të mblidhen bashkë një gjenetist, një biokimist, një palenteolog dhe një teolog për ta nxjerrë të vërtetën në shesh jo për një vend apo shoqëri të caktuar a të kufizuar, por për të gjithë botën! Ndërkaq, sot, në emër të shkencës, çështja e evolucionit mbrohet si një dogmë kategorike më intransigjente se dogmat ideologjike, për çka dhe mendimi për ta vënë në diskutim atë, madje, konsiderohet faj!

Nga ana tjetër, duke e lënë mënjanë faktin se a kemi, më në fund, ne, teologë për ta diskutuar në mënyrë shteruese këtë çështje, na duhet të themi se sot na qëndron para si një e vërtetë e hidhur fakti që sistemi ynë arsimor teologjik nuk është në atë nivel që dëshirohet dhe që, prej disave, ka një shekull që ëndërrohet, si dhe nuk i përfshin shkencat e natyrës të paktën me parimet e tyre të përgjithshme. Ja, pra, mbi një truall të tillë, megjithëse shumica e specifikave që do të përpiqem t'i parashtroj këtu, nuk futen drejtpërdrejt në fushën me të cilën merrem unë, meqë parashtrimin dhe shqyrtimin, me sa ma lejon njohja ime, të kësaj çështjeje që qëndron pothuaj si një mur ndarës mes besimit dhe mohimit, e shoh si një detyrë, si një përgjegjësi, e kam krejtësisht të qartë se jam duke ia hyrë një pune tejet të vështirë për t'ia dalë në krye. Çështje e vërteta, mendimi themelor që qëndron nën iniciativën për t'ia hyrë një pune të tillë me shpresën se do të më falin specialistët e çështjes në fjalë, sështë gjë tjetër veçse dëshira për t'u dhënë një shtytje kompetentëve të kësaj fushe. Dhe dëshiroj që ata ta marrin përsipër këtë barrë në mënyrë që kjo çështje t'u pohohet në tërë lakuriqësinë e saj brezave të plagosur, të cilëve ka që prej më shumë se një shekulli që po u zhbirohen trutë e po u grabitet besimi, dhe çdo gjë të vihet në shesh në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj!

Në fakt, më duhet të pohoj se, në vend të preokupimit me një temë të tillë, unë parapëlqej të flas për parimet bazë të Islamit që e besoj dhe që e përjetoj me emocion, të vë në pah vetitë e një brezi që do ta shpëtonte njerëzimin. Unë mendoj se të tregosh për

vetitë konstruktive zgjon më shumë emocion në zemrat që besojnë. Kurse bëhem dëshmitar dhe mbetem pa mend para faktit që njerëz me shkollë e pa shkollë, universitarë e jo të tillë, madje një sërë dijetarësh dhe funksionarësh fetarë bëjnë pohime dhe deklaratat kontradiktore në lidhje me çështjen e krijimit e cila është e mbështetur me ajete kuranore, për rrjedhojë, i intereson besimit, si dhe bëjnë interpretime, sipas të cilave, ajetet e Kuranit dhe thëniet brilante të derdhura nga buzët e bekuara të Profetit mund të shtjellohen me anë të darvinizmit!(?)

Dijetari Hysejin Xhisri ndaj të cilit ndjej shumë respekt, një shekull më parë, kur përballej me një pyetje rreth kësaj teme, thoshte: “Kjo çështje është ende një teori, por, nëse në të ardhmen na parashtrohet si një e vërtetë pozitive, atëherë edhe ne e përshtasim atë me ajetet e Kuranit.” Sado respekt që të ndjej për këtë dijetar të madh, është e pamundur të bashkohem me opinionet përkatëse të tij dhe të shumë të tjerëve që mendojnë si ai mbi këtë temë. Sepse idetë e Darvinit mbi evolucionin dhe teoria e evolucionit kurrë nuk do të mund të përshtaten ose përputhen me ajetet-argumente të Kuranit ngaqë ky nuk e interpreton jetën si rezultat imediat rastësor të një sërë shkaqesh rastësore. Dhënia e jetës dhe e vdekjes janë dy akte ekskluzivisht hyjnore, pra, që i përkasin, në mënyrë të padiskutueshme, Zotit. Edhe pse për të dyja, për momentin fillestar të tyre, bëhet fjalë për një sërë shkaqesh materiale, në mënyrë të posaçme jeta është krejtësisht mbishkakësore. Dhënia e jetës është një akt i thjeshtë, esencial, primar, i paparaprirë nga asnjë lloj shkaku, i Zotit. Prandaj, meqë jeta nuk do të mund të shpjegohej me asnjë lloj shkaku material-lëndor, jo vetëm ajo është një e vërtetë që qëndron përtej të qenit një teori darviniane, por edhe kjo teori nuk do të mund të interpretohet dhe përshtatet me anë të ajeteve-argumente kuranore dhe të pohimeve të Traditës Profetike! Ja, pra, ky është edhe një nga motivet që më shtynë ta trajtoj këtë temë!

Darvinizmi është një teori që kurrë nuk do të mund t'i atribuohet një personi të vetëm, qoftë ky Lamarku ose Darvini. Veç atyre

që e patën hedhur në shesh këtë teori shekullin e kaluar, sot janë neodarvinistët të cilët, kinse për ta provuar evolucionin, për ta mbështetur Darwinin në teorinë e tij, për t'i gjetur pajandra asaj, janë duke zhvilluar teorira që, sa herë që njëra prej tyre nuk zë, zëvendësohet nga tjetra! Mirëpo ec e shih se si kjo teori e pavërtetuar si dhe teorizimet e tjera ndihmëse u mësohen nxënësve e studentëve si të vërteta shkencore të provuara apo të provuara përfundimisht në të gjithë sistemin arsimor-edukativ nga shkolla tetëvjeçare në universitete! Me këtë rast, edhe pse këto që do të them nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çështjen, dëshiroj t'i lutem Krijuesit Transcendental që brezat e lumtur të së ardhmes ta ndriçojnë edhe këtë çështje, si të tjerat, në të gjitha aspektet e saj për të mos i preokupuar shkollat dhe katedrat shkencore me teori të tilla të pamundura për t'u provuar dhe vërtetuar!

Ndërkaq, veçanërisht në shek. XX janë ata që e kanë bartur teorinë e evolucionit nëpër laboratore me qëllim për ta provuar me anë të mutacionit. Prandaj mendojmë ta trajtojmë këtë temë në kuadrin e darvinizmit, neodarvinizmit, mutacionizmit, si dhe të konkluzioneve kategorike të Kuranit mbi krijimin dhe pohimeve autentike e të pandryshueshme të Profetit (mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi Të!).

## EVOLUCIONI

*Evolucion* i themi zhvillimit nga e thjeshta, te e përbëra, nga një cilësi më e ulët, në një cilësi të re, më të lartë. Në fillim, teoria mbi prejardhjen dhe zhvillimin e qenieve të gjalla u quajt *darwinizëm*, pastaj, për ta emërtuar atë, nisi të përdorej fjala e ardhur nga latinishtja, *evolucion*. Në ditët tona, fjala *evolucion* përdoret në kuptimin *zhvillim dhe përkryerje duke kaluar nga një etapë në tjetrën* si dhe, në kuptimin e ngushtë dhe teknik, jo për të emërtuar darvinizmin, por *mutacionet dhe transformimet në botën e gjallë si pasojë e ndikimeve të brendshme e të jashtme*. Prandaj, kur themi *evolucion*, e kemi fjalën për të gjitha *idetë darviniste të vjetra e të reja*.

Çështje e vërteta, edhe para Darvinit ka pasur njerëz që kanë paraqitur pretendime të ngjashme. Mes tyre, përmenden Kanti, Bekoni, Hegeli.

Në fakt, është vetëm Lamarku me teorinë e tij të transformizmit, ai që, para Darvinit, ka bërë fjalë mbi evolucionin në kuptimin biologjik të tij. Veprën “Filozofia e Zoologjisë” ku Lamarku zhvillonte teorinë e vet, e pati botuar në vitin 1809 kur pati lindur Darvini. Ndërkaq, vepra e Lamarkut u bë e njohur jo menjëherë, por pas disa vitesh, atëherë kur edhe Darvini pati ardhur në moshën për të lexuar dhe kuptuar.

Mund të flitet për tre faktorë ndikues që e shtynë Darwinin për ta parashtruar teorinë e tij të famshme. I pari është prifti anglez Maltus. Në një periudhë kur në Angli sundonte varfëria, Maltusi i cili e shihte shtimin e popullsisë si njërin prej shkaqeve të varfërisë dhe dilte kundër ligjit në fuqi mbi ndihmën e shtetit për të varfrit, në veprën e tij, “Ese mbi parimet e popullimit” (1789), pretendon-



te se, ndërsa popullsia shtohet në progresion gjeometrik, të mirat materiale shtoheshin në progresion aritmetik ose, më saktë, vinin gjithmonë duke u pakësuar, prandaj edhe pse fatkeqësitë natyrore, sëmundjet, etj. shtonin artificialisht vdekshmërinë dhe bënë një skartim të dukshëm të numrit të popullsisë, shtimi i saj në progresion gjeometrik do të bënte që të vinte një ditë që ajo të mos mund të ushqej dot më, prandaj s'kishte aspak kuptim që me ligje të tillë si ai aktual që ushqente të varfrit, të ndihmohej artificialisht keqësimi i gjendjes! Kështu, Maltusi kërkonte shfuqizimin e ligjit në fjalë. Kurse Darvini, nga një pretendim i tillë i mbrojtur për arsye ekonomike, u përqendrua në nxjerrjen, sipas tij, të përfundimeve shkencore, për të ngritur, më tej, teorinë e përzgjedhjes natyrore.

Faktori i dytë me ndikim të rëndësishëm mbi Darwinin është Alfred Rasëll me veprën e tij, “Kontribute për teorinë e seleksionit natyror”. Ndërsa Rasëlli bënte kërkime në ishujt Malaja, Darvini bënte kërkime në brigjet e Amerikës Jugore dhe ishujt e Oqeanit Paqësor. Në letrën e tij të gjatë sa një libër drejtuar Darwinit, Rasëll i shkruante se gjallesat që përshtateshin më mirë ndaj mjedisit mund ta vazhdonin jetën dhe, në këtë kuadër, mes gjallesave zhvillohej një luftë për ekzistencë. Ja, edhe nga ky pretendim mori guxim Darvini si kur po e përvijonte teorinë e tij, ashtu dhe kur e hidhte në shesh.

Faktori i tretë me ndikim të rëndësishëm mbi Darwinin janë mendimet e disa shkencëtarëve të cilët, para Darwinit, kanë bërë fjalë në një farë mënyre mbi evolucionin. Ndërkaq, mendimet e tyre, që në kohën e vet patën ushtruar ndikim mbi Darwinin, sot nuk kanë ndonjë vlerë, siç ndodh, bie fjala, me Lamarkun. Kurse Për Darwinin ekziston konsiderata se ai i ka sistemuar dhe shprehur mendimet e tij në mënyrë më shkencore, mirëpo, kur t'i parashtrijmë në këtë libër disa të vërteta, qoftë edhe të thjeshta, do të duket se, si pretendimet e Darwinit, ashtu dhe sistematizimi dhe parashtrimi i tyre prej tij janë mjaft larg nga metodologjia dhe vërtetësia shkencore!

## KATËR TEZAT KU MBËSHTETET DARVINIZMI

Darvini niset nga disa ngjasime mes gjallesave. Së bashku me të, edhe shkencëtarët që kanë ushtruar ndikim mbi të, i mbështesin tezat e tyre mbi këto katër pretendime kryesore:

1. Kushtet e mjedisit të jashtëm së bashku me faktorët ndikues të brendshëm ushtrojnë ndikim mbi gjallesat duke shkaktuar mbi to disa ndryshime relative.

2. Këto ndryshime u sjellin gjallesave dobi dhe zhvillim.

3. Këto ndryshime (të vogla) përcillen në brezat pasardhës me anë të trashëgimisë.

4. Në natyrë zhvillohet në mënyrë të pandërprerë një përzgjedhje natyrore. Gjallesat luftojnë me njëra-tjetrën për të siguruar ushqimin dhe ekzistencën. Jeta e gjallë është pikërisht kjo luftë që zhvillohet mes gjallesave për ekzistencë. Gjatë kësaj lufte, individët e fortë dalin fitues dhe vazhdojnë ekzistencën, kurse individët e dobët janë të dënuar të munden dhe asgjësohen. Përzgjedhjen (seleksionimin) natyrore si rrjedhojë e luftës për ekzistencë, e ndihmojnë edhe fatkeqësitë natyrore që nuk munden të përballohen nga individët e dobët. Kështu, gjatë këtyre dy formave të përzgjedhjes, jo vetëm zhduken individët e dobët, por edhe individët e fortë që kanë arritur ta përballojnë luftën apo fatkeqësitë natyrore, dalin edhe më të fortë, me cilësi më të larta, për rrjedhojë, mbi tokë shfaqen lloje (varietete ose specie) të reja me cilësi më të larta. Kjo ide mbështetet mbi pikëpamjen ekonomike të Maltusit që u përmend pak më lart.

Dhe, tani, le të përpiqemi t'i shqyrtojmë me detale këta katër elementë që përbëjnë bazën e darvinizmit.

## PRETENDIMI MBI EVOLUCIONIN DHE NGJASHMËRITË MES GJALLESAVE

Darvini niset nga ngjashmëria që vihet re në natyrë. Sipas tij, apendikset që vihen re te disa gjallesa të larta si pasojë e dukurive atrofizuese, janë organe të bartura prej tyre nga fazat e tyre të ulëta gjatë procesit të evolucionit dhe që tani nuk vlejnë për gjë. Bie fjala, sipas Darvinit, qimet në trupin e njeriut janë bartur te njeriu nga gjitarët më të ulët me rrugën e trashëgimisë. Gjatë këtij procesi, shumica e qimeve kanë rënë dhe kanë mbetur vetëm një pjesë e vogël e tyre. Mirë, po pse, vallë?

Këto lloj pretendimesh të Darvinit nuk kanë ndonjë aspekt konsekuent. Fakti që njeriu ka fytyrë, sy, vesh, etj., si dhe majmuni, nuk do të thotë aspak se njeriu ka rrjedhur nga majmuni; gjithashtu, fakti që në disa lloje gjallesash ka organe të njëjta ose të ngjashme, nuk tregon se ato gjallesa kanë rrjedhur nga njëra-tjetra! Në gjithësi ekzistojnë shumë lloje (specie) gjallesash, mes të cilave ka shumë ngjashmëri, sepse të gjitha gjallesat, në ndërtimin e tyre, bazohen në katër elementë: azot, karbon, oksigjen dhe hidrogjen. Gjithashtu, edhe njeriu, edhe kafshët, ushqehen me shumë lëndë ushqimore të përbashkëta. Në mënyrë të veçantë, njerëzit përdorin të njëjtat lëndë ushqimore. Megjithatë, të gjitha llojet e gjallesave ndryshojnë mes tyre si dhe çdo individ njerëzor ndryshon shumë nga tjetri në shumë aspekte dhe cilësi të tij. Ngjashmëritë mes llojeve në strukturë dhe pamje nuk janë domosdoshmëri dhe provë e prejardhjes së tyre nga njëra-tjetra. Dallimet që vihen re pavarësisht nga uniteti i burimit, tregojnë se synimi dhe, në vartësi të këtij, kuptimi dhe funksioni të gjallesat janë parësore, për çka dhe struktura lëndore-materiale e tyre është rregulluar sipas këtij pariteti. Në praktikë kurrë nuk ndodh që të ndërtohet një ndërtesë sidokudo ose, e kundërta, shumë e bukur

dhe e përsosur dhe vetëm pastaj të mendohet ose përshtatet funksioni i saj. Nuk formohen fjalët e nuk shkruhet libri pa një ide e pa një përmbajtje paraprake të formuar në mendje. Çdo ndërtesë përbëhet, pak a shumë, prej të njëjtash materiale ndërtimi, mes llojeve të ndryshme të ndërtesave ka shumë ngjashmëri, por asnjëra prej tyre nuk është identike me tjetrën (vetëm nëse paraprakisht është e menduar dhe e vendosur kjo gjë). Shkronjat që përbëjnë fjalët dhe gjuhët, janë të numërueshme, janë pak, kurse numri i pallogaritshëm i fjalëve të qindra gjuhëve, dialekteve, nëndialekteve, etj. formohet vetëm me ca pak shkronja në sajë të kombinimeve të pafund! Bie fjala, ndryshimi i vetëm një shkronje sjell ndryshime kuptimi në disa fjalë shtatëshkronjëshe me gjashtë shkronja të njëjta. Kështu, mund të ketë shtatë fjalë të ndryshme shtatëshkronjëshe me gjashtë shkronja të njëjta dhe vetëm një të ndryshme, por që sështë kusht të jenë të prejardhura nga njëra-tjetra. Është kuptimi ai që i përfton ekzistencë çdo fjale dhe që cakton materialin e saj të përbërë prej tingujsh dhe shkronjash. Po si kjo, ndër gjallesat, për funksione të ngjashme, janë të domosdoshme organe të ngjashme dhe struktura të ngjashme. Shumëllojshmëria e pafundme që vihet re në botën e gjallesave pavarësisht nga një sërë ngjashmëriash strukturore dhe përdorimit të të njëjtit material lëndor ose, duke u nisur nga e kundërta, ngjashmëritë strukturore që vihen re pavarësisht nga shumëllojshmëria e pafundme, aludojnë plotësisht për një synim, për një vullnet, për një kuptim evident. Prandaj, gjallesat janë krijuar e krijohen sipas shkakut dhe synimit të ekzistencës, duke u dhënë strukturë dhe organe të përshtatshme për secilën prej tyre. Për rrjedhojë, ngjashmëritë mes gjallesave, në kundërshtim me ç'pretendon Darvini, nuk tregojnë për prejardhjen e tyre evolucionare, por për krejt të kundërtën!

E dyta, mbi tokë ka gjallesa të panumërta dhe qindra-mijëra lloje (specie). Po që se çdo lloji do t'i jepej një strukturë krejt e veçantë dhe çdo individ i të njëjtit lloj, strukturë, organe dhe pamje e veçantë, do të duheshin struktura, organe dhe karakteristika të panumërta. Ndërsa kur e mendojmë këtë çështje për njeriun,

meqë çdo individ njerëzor do të ishte i prejdardhur prej një lloji të veçantë të botës shtazore, do të kishte një strukturë dhe një pamje të veçantë. Pa dyshim, Zoti është i aftë t'i japë çdo lloji dhe çdo individ një strukturë dhe pamje të veçantë dhe, kur e mendojmë këtë gjë edhe për njeriun, e kuptojmë se atëherë do të ishte krejt e pamundur njohja, afrimi, grupimi, ndihma reciproke dhe jetesa e përbashkët si për kafshët, ashtu dhe për njerëzit, individët do të mbeteshin të huaj për njëri-tjetrin dhe në shesh do të dilte një botë e pajetueshme.

Në mënyrë të veçantë, dy gjëra që i përngajnë njëra-tjetrës, nuk do të thotë se janë identike të njëra-tjetrës. Bie fjala, edhe esenca e trëndafilut, edhe acidi klorhidrik janë lëngje që kanë veti të ngjashme si avullueshmëria e lartë, etj., por, ndërsa esenca e trëndafilut të jep kënaqësi, acidi klorhidrik të shkakton djegie dhe plagë. Po kështu, dielli, llamba elektrike, qiriu, pisha japin dritë, ndriçojnë, por nuk kanë të njëjtin burim. Fakti që në strukturën e kafshëve dhe njerëzve ka organe të ngjashme ose që mes kafshëve dhe njerëzve ka ngjashmëri të mëdha, nuk tregon se mes dy llojeve ka një lidhje kalimtare. Sepse çdo gjallesë i jepen organet e duhura për jetën dhe për të kryer funksionet jetësore përkatëse. Veç kësaj, është kuptuar se organe që gjer dje janë konsideruar si atrofizime dhe apendikse, kanë dhe kryejnë funksione shumë të rëndësishme!

Krahas kësaj, në natyrë, disa herë mund të ekzistojnë elementë që duket sikur nuk i përshtaten mjedisit ku ndodhen dhe strukturës së përgjithshme të tij. Jo mund të ekzistojnë, por ekzistojnë. Ndërkaq, jo vetëm mund të qëndrohet për të dalluar se ç'kuptim ka ekzistenca e tyre në atë vend, por ne as që mund të pretendojmë ende se e kemi zbërthyer strukturën e natyrës. Pastaj, disa herë, një gjë mund të vihet si një element dekoracioni në një vend jo krejt të përshtatshëm dhe, për rrjedhojë, mund të tërheqë vëmendjen mbi vete. Po qe se vështrimi ngulet pikërisht mbi këtë element dhe njeriu, duke u mbështetur mbi të, jep një konkluzion të përgjithshëm mbi krejt strukturën, bie në gabim. Ashtu siç është gabim që, duke

parë vetëm dy dyer të mbyllura të një pallati me dy mijë dyer, të konkludosh se të gjitha dyert e pallatit janë të mbyllura, ashtu siç është gabim që, duke e ngulur vështrimin vetëm mbi dy kokrra të kalbura të një peme me rrënjë, trung, degë e gjethe të shëndosha, të nxjerrësh përfundimin se pema i ka të gjitha kokrrat të kalbura, ashtu është konkluzion joshkencor e i shpejtuar të thuash se midis dy llojeve ka një lidhje kalimtare prejardhjeje dhe evolucion vetëm duke u nisur nga një a dy të ashtuquajtura apendikse të konsideruara si pasojë të një procesi atrofizimi!

I nisur nga ngjashmëritë, Darvini e vlerëson si argument tjetër për teorinë e tij të evolucionit faktin se disa sëmundje të njeriut hasen edhe te kafshët. Edhe për këtë mund të thuhet e njëjta gjë që u tha më lart. Me sa dihet gjer më sot, te njeriu hasen dhjetëra e qindra sëmundje dhe variante të tyre. Po që se do të kishte sëmundje të ndryshme për çdo lloj gjallese, numri i sëmundjeve do të ishte shumë i madh. E dyta, është krejt e natyrshme që te njerëzit dhe kafshët me strukturë, organe dhe funksione mjaft të ngjashme, të ketë sëmundje të ngjashme, por nuk është aspak e natyrshme dhe me vlerë të konkludosh se këto gjallesa e kanë prejardhjen nga njëra-tjetra. Kështu, sëmundjet e njerëzve nuk vërehen te majmunët as në mënyrë tipike, as me ndryshime, kurse një a më shumë prej tyre vërehen te kafshët e tjera. Bie fjala, emfizema kronike haset te kuajt, leucemia haset te macet dhe bagëtitë e trasha, distrofia muskulare haset te pulat dhe minjtë, arterioskleroza haset te derrat dhe pëllumbat, çrregullimet e koagulimit të gjakut dhe nefritet hasen te qentë, ulcerat e stomakut hasen te derrat, anevrizma haset te gjelat e detit, gurët e tëmthit hasen te lepujt, inflamacioni i heparit haset te qentë dhe kuajt, gurët e veshkave hasen te qentë dhe të trashat, katarakti haset te qentë dhe minjtë.

Në këto kushte, a mos do të pretendojmë se njeriu ka rrjedhur nga minjtë, qentë apo buajt? Te njerëzit dhe kafshët mund të gjenden të njëjtat viruse apo baktere. Megjithëkëtë, ky fakt nuk është argument i prejardhjes së njëjtë. Janë disa sëmundje të përbashkëta të njerëzve, zogjve e shpendëve, ndërsa këta të dytët janë biologjikisht

shumë larg njeriut. Afrimi i njeriut, duke u nisur nga ky fakt, me pulën, do të thotë largim nga pikëpamja bazë e Darvinit, i cili, në linjën evolucionare të zhvillimit, mes njeriut dhe kafshëve të tjera ka vënë majmunin!

## ÇËSHTJA E PËRDORIMIT DHE MOSPËRDORIMIT TË ORGANEVE DHE PËRSHTATJA

Duhet ta bëjmë të ditur se edhe pretendimi se organet që s'përdoren, me kalimin e kohës atrofizohen, si dhe pretendimi i Lamarikut se, te llojet e gjallesave, cilësitë e fituara me kalimin e kohës u kalojnë brezave pasardhës me anë të rrugës së trashëgimisë, nuk kanë asnjë vlerë. Çështje e vërteta, te njerëzit vëmë re se disa organe që përdoren më shumë, sidomos muskujt, zhvillohen. Kështu vihet re një zhvillim i madh muskujsh te ngritësit e peshave. Mirëpo i biri i ngritësit të peshave nuk lind aspak me muskuj të zhvilluar ose, më saktë, gjatë rritjes, tek ai nuk vihet re ndonjë përjashtim në zhvillimin e muskujve në krahasim me bashkëmoshatarët që kanë lindur nga prindër me një zhvillim muskolor të zakonshëm. Që edhe i biri i ngritësit të peshave të bëhet si i ati, duhet të stërvitet si ai! Po kështu, hebrenjtë kanë rreth 4000 vjet që bëhen synet, megjithëkëtë, nuk është vënë re që fëmija i ndonjë hebreu të lindë i bërë synet! Edhe qindra milionë myslimanë kanë 14 shekuj që bëhen synet, por as mes myslimanësh nuk është dëgjuar të lindë ndonjë fëmijë i bërë synet! Për rrjedhojë, pranimi i përcjelljes te brezat pasardhës me anë të trashëgimisë i një cilësie të fituar nga një brez me kalimin e kohës, për më tepër, pranimi i kësaj si një tezë e padiskutueshme, është diçka që nuk përputhet me shkencën dhe dinjitetin shkencor.

Po si kjo, edhe pretendimi se organet që s'përdoren, me kohë atrofizohen dhe u përcillen në të njëjtën gjendje brezave pasardhës, kurse organet që përdoren, zhvillohen, është një legjendë dhe bestytни. Lamarku pretendon se "gjirafës i është zgjatur qafa në mënyrë anormale pasi ka pasur nevojë të arrijë degët e larta"! (?)



E cila është ajo kafshë bimëngrënëse që nuk kërkon të hajë gjethet e degëve më të larta? Pse, vallë, vetëm qafa e gjirafës është zgjatur, kurse e kafshëve të tjera, jo? Edhe dhitë ushqehen vazhdimisht me degë dhe gjethet pemësh dhe kjo mënyrë ushqyerjeje është aq karakteristike për to, sa që dhitë konsiderohen armiq të pyjeve! Mirëpo, ja që qafa nuk u është zgjatur, prandaj janë të detyruara të kacavirren për të arritur degët e larta! A nuk do të donte gjarpri të ecte mbi këmbë në vend që të zvarritej për tokë? Darvini ka një pikëpamje, sipas të cilës “këmbët e gjarprit janë atrofizuar me kalimin e kohës”. Kontradikta këtu është aq e hapur sa mund ta vërë re kushdo. Po qe se në botën e kafshëve ka vepruar dhe vepron evolucioni, do të duhej që, nëse gjarpri ka qenë në krye të herës zvarranik, me kohë t’i qenë formuar këmbët, kurse, nëse ka qenë me këmbë, s’kishte pse të mos i përdorte. Ç’ka shtyrë gjarpriin me këmbë të mos i përdorë ato, të kthehet në zvarranik dhe, pastaj, duke u hequr zvarrë, ta përdorë qafën për ta zgjatur? Nga njëra anë, i ka këmbët, por nuk i përdor dhe, nga një kafshë më e lartë, në vend që të evoluojë më tej, kthehet mbrapsht në një kafshë më të ulët! A nuk ka kontradiktë këtu?

Përsëri, sipas pretendimit të Darvinit, “krahët e zogjve kanë ardhur në këtë gjendje nga nevoja për të fluturuar”. Edhe në këtë pretendim ka një kontradiktë të hapur. Sigurisht, në krye të herës, zogjtë nuk kanë pasur krahë për të fluturuar. Atëherë, pse dhe si ka lindur te zogjtë nevoja për të fluturuar? Si u krye zhvillimi gradual i krahëve te zogjtë? Mos vallë duke bërë ushtrime fluturimi për miliona vjet me radhë? Dhe pse? Përse? Sipas teorisë së Darvinit, del se, në krye të herës, zogjtë ecnin mbi tokë së bashku me kafshët e tjera. Siç duket, ata *ishin të pajisur paraprakisht me fillesën e krahëve* që e ruajtën dhe e zhvilluan duke e përdorur gjersa e prunë në gjendjen e sotme! As Darvini vetë, as dhe ata që kapen fort pas teorisë së tij si të ishte e vërtetë, pra, që kapen pas saj si pas një dogme, nuk munden t’u japin as edhe një përgjigje bindëse pyetjeve dhe çështjeve të panumërta si më sipër që s’ke si u shmangesh dot!

Ata që ngulin këmbë te evolucioni, sjellin, kinse si argument për atrofizimin e organeve të papërdorura, zorrën qorre dhe bajamet tek njeriu. Duke tërhequr vëmendjen mbi faktin se zorra qorre ndodhet mes zorrëve të holla dhe zorrës së trashë, ata thonë se ajo ka mbetur nga etërit tanë barëngrënës, është atrofizuar me kohë nga mospërdorimi dhe është kthyer në një apendiks, në një organ pa funksion, të padobishëm. Po kështu edhe bajamet i shohin si të padobishme. Por sot shkenca tregon se bajamet funksionojnë si një pritë, si një barrierë ndaj mikrobeve që mund të futen të trupit përmes grykës. Edhe zorra qorre, në disa punime shkencore, quhet si një “stomak i dytë”. Fakti që në zorrën qorre ka një rrjet shumë të dendur kapilarësh gjaku dhe limfe, tregon për rëndësinë e tij.

Darvini bën fjalë edhe për atrofizimin e qimeve te njeriu dhe thotë: “Njeriu ka ardhur në gjendjen e sotme nga etërit e tij lesh-torë duke i rënë qimet (leshtrat)”. Kurse për ta shpjeguar faktin që tek femra nuk është e njëjta gjendje e qimeve, përdor një arsytim që s’përputhet aspak me idenë e evolucionit sipas tij: “Kështu është dashur të jetë që femra të jetë tërheqëse”!(?) Ky është një arsytim që mbështetet në urtësinë hyjnore të krijimit dhe, po të bëhet nga ky këndvështrim, qëndron. Por fakti që një teori që mbështetet në spontanitetin dhe rastësinë e verbër bën një arsytim të tillë për të justifikuar dallimin mes mashkullit dhe femrës në gjendjen e qimeve, është krejt kontradiktore, është një shmangie nga konsekuenca e vet ose, më saktë, pamundësi për t’iu shmangur së vërtetës! Darvini përpigjet ta justifikojë edhe faktin se pse nuk kanë rënë qimet e kokës, duke thënë se “ashtu duhej meqë koka ka qenë pjesa më e ekspozuar e trupit ndaj goditjeve”. Po balli, hunda, gjunjët, më pak të ekspozuara kanë qenë?(!)

Në lidhje me përshtatjen e gjallesave ndaj mjedisit të jashtëm, neodarvinistët mbrojnë këtë pikëpamje:

Në zonat industriale të Europës, në vendet me dendësi të madhe pluhurash dhe tymrash, ndodh dukuria e melanozës industriale. Në këto kushte, meqë fluturat e tenjës ose molës me ngjyrë të errët mbrohen më mirë nga armiqtë e tyre në sfondin e përhirosur të

mureve apo sipërfaqeve të tjera, skartohen më pak, domethënë shumohen më tepër se fluturat me ngjyrë të çelët, kemi të bëjmë me një proces ndryshimi që do të çojë, një ditë, në eliminimin e plotë të fluturave me ngjyrë të çelët.

Është e qartë se ky shembull nuk mund të shërbejë si argument për evolucionin, sepse qoftë e bardhë apo e zezë, si tenja e zhdukur, si tenja që ka mbijetuar, mbetet tenjë. Në këtë rast nuk kemi jo vetëm kalim në një lloj tjetër, por as ndryshim brenda llojit. Këtu bëhet fjalë vetëm për një cilësi të tenjës, aftësinë për t'iu përshtatur ndryshimit të kushteve të mjedisit, konkretisht me anë të ndryshimit të ngjyrës. E gjitha vetëm kaq!

Pretendimi se mes gjallesave të të njëjtit lloj ndodhin ndryshime si rezultat qoftë i një dukurie të natyrshme, qoftë i një izolimi artificial, domethënë i një detyrimi për të jetuar në kushte të caktuara, paraqitet dhe mbrohet si një argument i evolucionit, në themel të të cilit qëndron përshtatja. Ndryshime dhe dallime të tilla mund të ndodhin dhe duken në çdo kohë, por gjithmonë janë sipërfaqësorë dhe zhvillohen brenda të të njëjtit lloj. Nuk mund të pretendohet që një ndryshim i tillë brenda llojit të nxjerrë në shesh lloje të reja me anë të metamorfozave në zinxhirin evolucionar. Edhe nëse pretendohet, ky pretendim nuk bart asnjë vlerë shkencore!

### **Evolucioni dhe etapat që kalon fetusin në mitër**

Një pretendim tjetër që parashtrohet në lidhje me këtë çështje, është edhe ngjashmëria mes etapave të para që kalon në mitër fetusin njerëzor dhe të të njëjtave etapa që kalojnë vertebrorët e tjerë.

Studimet shkencore përkatëse tregojnë se ende nuk njihen plotësisht dhe hollësisht veçoritë e zhvillimit të një veze vertebrorësh të fekunduar dhe akoma më pak analogjitë e së njëjtës dukuri mes vertebrorëve. Disa vezë ose embrione zhvillohen më ngadalë, disa, më shpejt ose shumë më shpejt. Edhe nëse ka një ngjashmëri morfologjike në dukje, çdo gjallesë (në rastin tonë

konkret, çdo vertebror) ndjek një ecuri të posaçme në vartësi të veçorive individuale, të geneve, kromozomeve dhe kushteve materiale ku ndodhet.

Në lidhje me etapat që kalon fetusi njerëzor në mitër, Kurani jep të dhëna të qarta dhe të tilla që shkencat e natyrës i arritën vetëm katërmbëdhjetë shekuj pas tij!

*“Pa dyshim, Ne e marrim njeriun nga balta duke e kthyer në një esencë. Pastaj atë, në formën e spermës (embrionit të fekunduar nga spermatoidi) e vendosim në një vend të sigurt. Pastaj embrionin e kthejmë në një lëndë ngjitëse (si gjak i mpiksur) dhe, më pas, në një si copë mishi të përtypur. Më vonë, këtë copë mishi të përtypur e kthejmë në eshtra dhe eshtrat i veshim me mish dhe e bëjmë atë një krijesë të re (të veçantë). Shihni se sa mrekullisht krijon Allahu dhe mendoni!”* (Mu'minun, 12-15).

Në fillim, Kurani bën fjalë për faktin që prejardhja e njeriut është nga toka, domethënë, elementët përbërës të njeriut janë po ata që gjenden në tokë e në gjithësi dhe përmbahen, në mënyrë të koncentruar, në elementët ngjizës njerëzorë: vezën dhe spermatozoidin. Veza e fekunduar që shumohet me shpejtësi, kthehet në një lëndë ngjitëse që në Kuran quhet *alak*, e cila ngjitet pas mureve të mitrës për t'u ushqyer. Ndërkaq, duhet theksuar se Kurani ia dedikon këto realitete dhe zhvillime Allahut, Zotit. Sepse as spermatozoidi, as veza, as embrioni dhe format e tij të zhvilluara më tej janë të aftë për të kryer ndonjë veprim sado të vogël në sajë të vetëdijes apo vullnetit të vet. Është Zoti që i drejton të gjitha këto procese. Mënyra se si shprehemi ne duke i përshkruar të gjitha këto sikur të zhvilloheshin vetvetiu, është e figurshme. Kurse evolucioni dhe shkenca që e mbron atë, duke i shpjeguar me anë të vetvetishmërisë, spontanitetit dhe rastësisë, ekspozon një injorancë dhe mohim të paparë në histori! Pandej se prandaj ngul këmbë kaq shumë materializmi mbi evolucionin!

Lënda ngjitëse që ngjitet në muret e mitrës duke formuar një lidhje shumë të ngushtë me nënën, duke u shumëzuar dhe rritur

pandërprerë, kthehet në një lëndë si një copë mishi e përtypur dhe pa formë të përcaktuar ose, më saktë, në një grumbull qelizash. Pastaj, një grup prej atyre qelizave fillon të shndërrohet në krye në kërc, pastaj në eshtër. Pas kësaj formohen qelizat e indeve muskulore dhe fibrore dhe formohet mishi që vesh eshtrat. Të gjitha këto që Kurani i përshkruante hollësisht dhe qartë qysh para katërbëdhjetë shekujsh, embriologjia moderne i mësoi pasi i vëzhgoi me anë të rrezeve rëntgen. Mirë, po pse u mor me çështje të tilla shkencore Kurani, synimet kryesore të të cilit janë krejt të tjera? Siç duket, për t'i dokumentuar qysh më parë të vërtetat kundër të cilave do të dilnin më vonë teoritë e gabuara të orientuara për ta mohuar krijimin!

Pas veshjes së eshtrave me mish, Kurani, duke përdorur për krijimin e njeriut shprehjen *"halkan ahar"*, thekson se Zoti e krijoi njeriun si një gjallesë specifike. Ja, ky është momenti kur njeriu fillon të pajiset me një krijim të posaçëm vetëm për të!

Gjatë pesë etapave të para, domethënë, si embrion i fekonduar, si lëndë ngjitëse, copë mishi, eshtër dhe eshtër e veshur me mish, të gjithë fetuset e vertebrorëve duken si identikë. Në këto etapa, nuk dallohet nëse qenia që po zhvillohet është zog, peshk apo njeri. Mirëpo ky ngjasim që duket si identik, është sipërfaqësor, vetëm në dukje. Së pari, ashtu siç u tha edhe më lart, procesi te disa është shumë i shkurtër, te disa, i gjatë. Së dyti, çdo fetus i një gjallese të caktuar ka veçori të posaçme vetëm për të që s'do të mund t'i dallonim edhe sikur të futeshim në mitër (!), dhe zhvillohet në përputhje me to. Dhe jo vetëm kaq. Edhe mes individëve të të njëjtit lloj ka veçori të posaçme dhe dallime që i japin procesit të zhvillimit individualitet. Për shembull, çdo individ njerëzor që në këto etapa duket sikur nuk dallohet nga të tjerët, zhvillohet në një mënyrë të posaçme për të që do të nxjerrë, si përfundim, në shesh, një njeri me flokë, sy, hundë, buzë, gjatësi shtati, peshë, vija të gishtave, ADN, pamje, karakter, dhunti dhe aftësi origjinale, disa prej të cilave, të papërsëritshme te asnjë individ tjetër. Mes fetuseve njerëzore mund të bëhet fjalë vetëm për pika të përbashkëta që va-

ren nga lloji. Për shembull, meqë fetusin njerëzor ka për t'u bërë një krijesë e përkryer që do të dallohet mes krijesave të tjera për arsye, vetëdije dhe vullnet, dhe që, pasi të vijë në botë, do të ketë aftësinë për të mësuar, për të besuar dhe adhuruar, çdo fetus njerëzor është i pajisur me mjetet e duhura për ta arritur këtë synim. Ndërkaq, siç u tha më sipër, çdo fetus ka veçori të posaçme për vete si mjete për realizimin e dallimeve individuale. Programi ADN që e dallon atë gjallesë nga të gjitha gjallesat e tjera, është i shkruar në formë genesh në kromozomet. Ndërsa puna qëndron kështu, meqë në pesë etapat e para të fetuseve vertebrorë këto veçori nuk mund të shihen nga jashtë, mund të mendohet sikur të gjithë janë e njëjta e njëri-tjetrit. Atëherë, mbetet të themi se, edhe sikur fetuset e vertebrorëve si zogu, peshku dhe njeriu të jenë identikë me njëri-tjetrin gjë në përfundim të etapës së pestë, si mund ta shpjegojnë shkencëtarët dhe evolucionistët ndryshimin e menjëhershëm që ndodh në këtë moment? Hadithet, porositë profetike, thonë se në këtë moment *njeriut i fryhet shpirti dhe i shkruhet kaderi, e ardhmja, në ballë*. Meqë shkenca materialiste dhe evolucioniste nuk i pranojnë as shpirtin, as kaderin, të ardhmen e paracaktuar, si do ta shpjegojnë në këtë etapë diferencimin e menjëhershëm dhe prirjen e çdo individi njerëzor për t'u bërë ai që është, i ndryshëm nga të gjithë të tjerët? Po qe se ky diferencim buron nga shpirti dhe kaderi që i japin çdo njeriu individualitetin e vet të vërtetë, domethënë, nga veçoritë që e bëjnë atë një individualitet më vete dhe po qe se kjo gjë është një dukuri krejtësisht jomateriale, a nuk do t'i shtyjë shkencëtarët materialistë dhe evolucionistë të ulen për ta menduar çdo çështje nga fillimi? Kurse ne, në kundërshtim me pretendimet e evolucionistëve, mendojmë se në fetusin e çdo lloji shtazor ka dallime që janë të posaçme vetëm për të, dhe se në fetusin e çdo individi njerëzor ka dallime që do ta pranonin shpirtin dhe kaderin të posaçëm për të.

Pas etapës së pestë, fetusin njerëzor fillon të marrë pamje njeriu dhe të priret për t'u bërë individi që bart veçori të caktuara. Ky është procesi gjatë të cilit ai do të bëhet krijesë e përkryer. Ja, pra, në krijimin e njeriut, veçanërisht në këtë etapë të fundit të

krijimit të njeriut, Allahu e përfundon ajetin-argument që shpreh shkallën më të lartë e më gjithëpërfshirëse të atributit të Tij krijues ose, e thënë ndryshe, aftësinë krijuese të shkallës më të lartë e më gjithëpërfshirëse, duke thënë: “*Shih, pra, dhe mendo se ç’krijues i përsosur është Allahu!*” Kështu, meqë atributi “krijues” i Allahut shfaqet tek njeriu në shkallën më të lartë, njeriu është një qenie tejet e veçantë dhe e zgjedhur, e merituar e cilësimit *krijesë e përkryer*, e pajisur me madhështinë e attributeve hjjnore!

Si përfundim, fetuset e vertebrorëve shtazorë dhe njerëzorë, në etapat e para të zhvillimit i ngjasin njëri-tjetrit. Kjo ngjashmëri është vetëm në dukje, prandaj kurrë nuk mund të bëhet argument për evolucionin!

Astrofizikani i shquar anglez i shek. XX, Sir James Jeans, i konsideruar si Ajnshtajn i dytë, thotë se “*njerëzit shkrihen me shkencat me të cilat merren*”. Ata dëgjojnë me veshin e asaj shkence, shohin me syrin e saj, flasin për llogari të saj dhe jetojnë me emocionet e saj. Madje ai e shtrin këtë dukuri edhe te mjeshtëritë dhe artet. Ai thotë se një pianist profesionist, i cili është mësuar të dëgjojë, bie fjala, tinguj të caktuar në tastat 5 dhe 8 gjer në shprehi, edhe kur zbret apo ngjit shkallët, në shkallaret e pesë e të tetë dëgjon të njëjtit tinguj!

Disa që janë marrë me gjeometri, duke menduar se në planete të tjerë mund të ketë qenie si njeriu që mendon me figura gjeometrike, kanë nderur në Afrikë, Gadishullin Arabik dhe në shkretëtirën e Saharasë zjarre gjigantë në formë trekëndëshe e katërkëndëshe për t’u dhënë atyre krijesave të supozuara mesazhe gjeometrike. Ata që merren seriozisht me matematikë, pretendojnë se Artisti që ka krijuar gjithësinë, e ka krijuar sipas përmasave matematike. Edhe këta, ashtu si të parët që s’mendojnë më dot tjetër gjë veç gjeometrisë, e mendojnë çdo gjë vetëm në mënyrë matematike. Kurse Darvini është marrë gjithë jetën me kafshë dhe fosile kafshësh. Për rrjedhojë, meqë nuk ka dalë dot jashtë fushës me të cilën është marrë, e ka parë çdo gjë nga dritarja e kafshëve dhe fosileve, prandaj dhe ka bërë interpretime të papranueshme për

arsyen dhe shkencën. Në të njëjtën pozitë vazhdojnë të jenë edhe ata që, duke e pranuar me kokëfortësi dhe në mënyrë dogmatike teorinë e tij, vazhdojnë të përpiqen për ta provuar. Me mendimin e tij si më sipër, James Jeans tërheq vëmendjen mbi faktin se, megjithë dobitë e mëdha, specializimi sjell me vete edhe rreziqe!



## FOSILET

Ata që mbahen pas teorisë së evolucionit me qëllim për të zbuluar prejardhjen e jetës, u drejtohen fosileve edhe kinse për ta vërtetuar teorinë e vet, edhe sepse në periudhat historike nuk haset në ndonjë dukuri evolutive. Të njëjtën gjë ka bërë edhe Darvini. Si biri i një familjeje të pasur dhe i një babai mjek, e filloi arsimimin duke mësuar për mjekësi, por ikte prej shkolle për të shëtitur fushave e maleve për të vëzhguar bimësinë dhe, pasi nuk pati sukses në mjekësi, vendosi të mësojë për teologji. Ngaqë zgjuarsinë teorike e kishte në vend, por jo në atë nivel edhe zgjuarsinë praktike, ai pati vështirësi edhe në studimin e teologjisë; megjithëkëtë, më në fund, u bë si u bë dhe e gjeti profesionin e tij të përshtatshëm. Ai mori pjesë në një ekspeditë studimore të organizuar nga qeveria angleze dhe bëri kërkime në ishujt e Oqeanit të Qetë, Afrikë, Amerikën e Jugut dhe Australi, bëri krahasime mes kafshëve të ishujve Galapagos dhe kontinentit, shqyrtoi disa fosile, u përqendrua në aktivitetet e vullkaneve dhe koraleve, mbledhi bimë dhe insekte.

Shkurt, kur u shfaq vetvetiu domosdoshmëria e gjetjes së një lloji (specieje) të ndërmjetëm për të vërtetuar se majmuni dhe njeriu vijnë prej një ati të përbashkët dhe kalimin nga një lloj në tjetrin, u ndje nevoja për të gjetur dhe përdorur fosilet. Këtë duhet ta bënin paleontologët. Po qe se dalin paleontologë pa paragjykime, gjejnë fosile të ndërmjetme dhe thonë se është e mundur të bëhet lidhja mes majmunit dhe njeriut, duke gjetur edhe përkrahjen e gjenetistëve pa paragjykime, vetëm atëherë duhet pranuar një teori e tillë dhe duhet konsideruar me vlerë kryerja e kërkimeve dhe studimeve mbi të. Në të kundërt, është e pamundur që pretendimi evolucionist të quhet një teori shkencore!

## Fosilet e zogjve

Mes fosileve të gjetura gjer tani, flitet për fosilin e zogut të ashtuquajtur *arkeopteriks* (*Archaeopteryx*) me bisht të gjatë, me dhëmbë dhe kthetra në krahët e përparmë, duke pretenduar se ky është një lloj i ndërmjetëm mes zvarranikëve dhe zogjve. Duke u mbështetur në këtë, evolucionistët mendojnë se kanë gjetur një lloj ose brez të ndërmjetëm të procesit të evolucionit dhe, duke gjetur edhe hallkat e tjera të humbura, do të mund të mbushin zbrazëtirat mes shumëqelizorit të parë dhe njeriut për të provuar, ndërkaq, edhe se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit!

Në të vërtetë, nuk ka asnjë shenjë që të tregojë se kjo gjallesë e ashtuquajtur *arkeopteriks* është një etapë mes zvarranikëve dhe zogjve. Po u pranua ky si i tillë, atëherë nuk ka asnjë pengesë që edhe lakuriqi i natës të vlerësohet si i tillë, sepse, meqë lakuriqi i natës është një zog gjitar, fare mirë mund të pranohet si një etapë e ndërmjetme mes zogjve dhe gjitarëve.

Mirëpo, ashtu siç shkenca nuk bën fjalë për një periudhë kur lakuriqi i natës të mos ketë ekzistuar, ashtu siç lakuriqi i natës nuk ka pësuar asnjë ndryshim gjatë ekzistencës së vet, ashtu edhe evolucionistët vetë, madje, nuk mendojnë ta përdorin atë si provë dhe argument për evolucionin. Ashtu si në rastin e arkeopteriksit, edhe në disa zogj, në ditët tona, hasen sqepe me anë të dhëmbëzuara. Të vegjlit e zogut të quajtur *Opisthocomus hoatzin* që rron në pyjet e Amazonës, kanë gishta të lirë në krahë (flatra). Për rrjedhojë, të sillesh sikur janë zbuluar dhe njihen të gjitha gjallesat që kanë jetuar e jetojnë mbi tokë qysh në krye të herës e gjer më sot, qoftë edhe sikur njihen të gjitha llojet e kafshëve që jetojnë sot, për të ecur, duke u mbështetur mbi pretendime të tilla boshe, me qëllim për të kërkuar *etapa të ndërmjetme* mes hallkave të evolucionit prej në krye të herës gjer te njeriu, s'do të thotë gjë tjetër veçse ta shpenzosh kohën kot, dhe këtë kuptim do ta ketë edhe në të ardhmen, sepse do të duhet të gjenden miliarda fosile të ndërmjetme për miliona lloje gjallesash nga njëra tek tjetra! Mbi gjithçka, sa e çuditshme është që, ndërsa fosilet e kafshëve që kanë jetuar

por janë zhdukur si lloj, gjenden me shumicë, nuk gjendet qoftë edhe një fosil i vetëm që të provojë një etapë të ndërmjetme! Kurse gjallesa të tilla si dinozaurët që janë krijuar (ose kanë ekzistuar) në një të kaluar të caktuar dhe, pastaj, për shkaqe të kushteve të papërshtatshme të mjedisit apo të tjera, janë zhdukur si lloj, mund të shërbejnë si provë dhe argument jo i evolucionit, por vetëm i asgjësimit. Prandaj, fakti që, përkundër të gjitha këtyre, ka mëse një shekull që këmbëngulet mbi një teori të tillë duke bërë shpenzime tejet të mëdha, nuk mund të pajtohet kurrë me qëllimin e mirë për t'i shërbyer shkencës dhe të vërtetës. Nëse ende ka qarqe shkencore që vazhdojnë të merren me këtë punë, kjo ndodh sepse teoria e evolucionit është një dogmë që përdoret kundër krijimit, për rrjedhojë, kundër besimit të Zotit!

### Legjenda e kalit pesëthundrak

Një tjetër pikë ku mbështeten evolucionistët duke e marrë për provë të brezave të ndërmjetëm, është edhe historia ose, më saktë, përralla e kalit me pesë thonj (thundra). Sipas kësaj historie, kali i parë kishte pesë thonj, kurse vetë kishte shtatin e një dhelpre. Pastaj, duke kaluar nëpër fazat e quajtura *Eohippus*, *Mesohippus*, *Merychippus* dhe *Pliohippus*, me kohë, iu pakësuan edhe thonjtë. Po qe se këta fosile janë të vërtetë, me siguri që janë qenie që kanë jetuar si një lloj i veçantë dhe pastaj janë zhdukur. Lidhja e këtyre me kalin është e pamundur. Po qe se ngulim këmbë për një lidhje të tillë, na dalin para dy pyetje të rëndësishme: E para, pse thonjtë e kalit ranë nga pesë në një? E dyta, ndërsa e kishte shtatin sa të një dhelpre, pse iu rrit dhe mori përmasat e sotme? Shkenca nuk mund t'u përgjigjet asnjërës prej këtyre pyetjeve. Edhe sot ka kafshë me një, me dy, me tre dhe me katër thonj. Ka edhe kafshë si dhelpra që vazhdojnë të jetojnë si ajo në të njëjtat kushte jetese. Ka edhe kafshë me pesë thonj dhe ende jetojnë si të tillë. Pse kali i hodhi katër thonjtë dhe na doli para me një thua (si njëthundrak), me shtatin të rritur? Po u tha se iu zgjatën këmbët nga nevoja për të vrapuar, atëherë del pyetja: Pse qeni i gjahut nuk u rrit sa kali?

Edhe qeni i gjahut vrapon të paktën sa kali, është më i përshtatshëm për t'u rritur si shtat dhe është më i lëvizshëm se ai. Ndërsa kali i hedh thonjtë dhe rritet, pse qeni i gjahut të mbetet sa ka qenë?

Ekzistenca e brezave (llojeve) të ndërmjetëm duhet t'u përgjigjet edhe kushteve të gjenetikës, sepse, duke u nisur nga shembulli i kalit, që dhamë, themi se nuk mund të mendohet që një kafshë që ka jetuar dikur si dhelpër, të kthehet menjëherë, me një mutacion, në kalë! Kjo është sikur një njeri të ngjitej (vetë) në çast nga lartësia 0 metra në lartësinë 10000 metra! Prandaj, jo një mutacion i kësaj përmase, por, ndonjëherë, edhe një mutacion i vetëm mund ta asgjësojë një gjallesë. Për rrjedhojë, është e domosdoshme ekzistenca e fazave të ndërmjetme që e ndjekin rregullisht njëra-tjetrën. Me të vërtetë, edhe kërkimet këtë linjë ndjekin. Kërkuan dhe gjetën një sërë fosilesh të reja e të vjetra, por nuk gjetën dot asnjë fosil që të tregonte kalimin gradual nga pesëthundrakët, në katërthundrakë, në trethundrakë, në dythundrakë, në njëthundrakë. Veçanërisht u përqendruan në fosilet që do ta lidhnin njeriun me majmunin, bënë fjalë për fosile që i mbiquajtën *Australopithecus*, *Homo erectus*, *Neandertal*, *njeriu i Javas*, *njeriu i Pekinit*, dhe thanë se këta janë gjallesa që përbëjnë fazën kalimtare mes majmunit dhe njeriut.

Po qe se dora e një fosili është gjetur këtu, kurse koka pesëdhjetë metra më tej dhe disa eshtra disa metra më thellë, nuk është e sigurt që këto të gjitha t'i përkasin një individi. Ndoshta një eshtër është e një kafshe që ka jetuar në periudha shumë më të hershme se një kafshë nga e cila ka mbetur një eshtër tjetër. Për rrjedhojë, është e pamundur të formohet një opinion i prerë në këtë drejtim!

Evolucionistët shkuan aq larg në kërkimin e një brezi të ndërmjetëm mes majmunit dhe njeriut, saqë në vitet 1912-1914 folën për *Njeriun e Piltdounit* si ati i vërtetë i njeriut. Fosili i gjetur përbëhej nga kafka e një njeriu 500-vjeçar me nofull orangutangu dhe dhëmbë njeriu. Por në vitet 1953-1954 doli në shesh se ky ishte një fosil i montuar dhe i treguar me rrugë kimike si shumë i vjetër.

Këto lloj sajimesh na e vështirësojnë besimin në studimin e fosileve dhe e forcojnë tezën se evolucioni është, më shumë se sa një çështje shkencore, një bindje, një çështje ideologjike!<sup>1</sup>

Një dimension tjetër i çështjes është ky: Sipas përcaktimit të paleontologëve, më i vjetri i fosileve për të cilët bëhet fjalë, i përket një kohe 1,5 milion vjet më parë. Mirëpo, në Kenia, në breg të liqenit Rudolf, u gjet një fosil njeriu që ka jetuar 2,8 milion vjet më parë. Në këtë mes, ka edhe kundërshtime në lidhje me metodën e përcaktimit të moshës së këtij fosili. E rëndësishme për ne është e vërteta se njeriu ka ekzistuar mbi tokë para majmunit ose, të paktën, në një kohë me të!

### Format iluzive të kalimit nga majmuni në njeri

Në librat shkollorë vendosen pranë e pranë figura qeniesh pak a shumë të ngjashme kinse për të ilustruar etapat kalimtare të evolucionit: një majmun, një gjysmë majmun dhe gjysmë njeri, një qenie më afër njeriut se majmunit dhe, më në fund, një tip mashkulli evropian me moshë mesatare. Ç'mashtrim i madh! Pse jo të gjithë majmunët, por vetëm një lloj prej tyre ka pësuar një evolucion të tillë? Pastaj, pse na tregohet një mashkull në moshë të mesme e jo një femër? Si është zhvilluar evoluimi i femrës? Sa copë majmunë së bashku kanë hyrë në rrugën e evolucionit, një apo disa? Po qe se, siç pretendohet, rasti i ka bashkuar shumë majmunë në një ishull ku ata kanë evoluar në njeri, ç'ka penguar që e njëjta rastësi

<sup>1</sup> Mashtrimet e bëra në emër të evolucionit nuk mbetën të kufizuara vetëm me këtë shembull. Evolucionistët dolën me pretendimin se peshku Coelacanth (Rhipitisan Crossopterigian) është një lloj ndërmjetës mes qenieve detare dhe tokësore, i zhdukur rreth 70 milion vjet më parë. Mirëpo në vitin 1939 ky lloj peshku u kap në ujërat pranë Madagaskarit dhe, pas asaj dite e gjer më sot, janë kapur edhe rreth pesëdhjetë peshq të tjerë të tillë. Veç kësaj, tek ky peshk nuk ndodhen ato cilësi (si hapësirat e veshit të brendshëm, eshtra e kurrizit në formë koke dhe qeska e notimit) që i shtynin evolucionistët ta paraqisnin këtë peshk si një lloj ndërmjetës. Si përfundim, evolucionisti A.H. Clark ka mbetur i detyruar të pohojë se nuk kanë hasur në asnjë fosil apo grupe gjallesash që mund të jenë lloje të ndërmjetme, për rrjedhojë kurrë nuk ka ekzistuar ndonjë lloj i ndërmjetëm! Edhe Richard B. Goldschmidt, me pohimin se nuk ekzistojnë formante të ndërmjetme, mbron tezën se boshllëqet mes llojeve mbushen me kapërcime të menjëhershme, gjë që nuk mund të shpjegohet me asnjë lloj metode shkencore, veçse duke pranuar krijimin hyjnor. (The Fountain, Nr. 24, f. 14.)

të mos ndodhte paralelisht në një vend tjetër ose të mos përsëritej e njëjta gjë edhe më vonë në mënyrë të përsëritur? Mbushja e të gjitha boshllëqeve të këtij pretendimi me hipoteza dhe rastësi, me ç'kritere dhe seriozitet shkencor mund të shpjegohet? Po që se do të tregohej i njëjti zell për argumentimin e krijimit hyjnor, a nuk do të ishte më e lehtë dhe më shkencore të bëhej një sistematizim i botës së gjallë duke u mbështetur në dijen, vullnetin dhe fuqinë hyjnore?

## ÇËSHTJA E MUTACIONIT

Njëra prej të ashtuquajturave baza të pikëpamjes evolucioniste është edhe hipoteza se ndryshimet në kodin gjenetik të gjallesave që pretendohet se ndodhin vetvetiu ose rastësisht ose si rezultat i kushteve të mjedisit, shkaktojnë kalimin nga njëri lloj në tjetrin.

Kromozomet në bërthamën e qelizës, e cila funksionon si qendër informacioni dhe drejtimi, përmbajnë genet. Të gjitha veçoritë specifike të një gjallese janë të regjistruara në genet (ADN). ADN, e cila është pothuaj si një depo gjenetike informacioni, një pasqyrë e përsosur vullneti, e krijuar në atë mënyrë që të mund ta kopjojë edhe veten e vet. Ashtu siç na i nxjerr kompjuteri, me vullnetin tonë, në ekran informacionet e regjistruara më parë në kujtesën e tij, ashtu edhe ky mekanizëm e zbaton pa të metë programin e përmbledhur në përmbajtjen e tij, madje e shifron këtë program pa pushim. Në saje të këtij shifrimi, duke dhënë urdhrat përkatëse, ky program mbron llojin të cilit i përket, domethënë, asnjë ndikim i jashtëm nuk mund t'i kapërcejë barrierat e tij për ta ndryshuar linjën e llojit përkatës me anë të mutacioneve ose mënyrave të tjera.

Dihet se, nën ndikimin e radiacioneve të ndryshme, të lëndëve kimike dhe të kushteve të mjedisit, në kodin dhe programin gjenetik të gjallesave ndodhin disa ndryshime. Por, njëkohësisht, dihet se këto ndryshime të quajtura mutacion, të shkaktuara në kodin gjenetik për një shkak çfarëdo, nuk i hapin udhë kalimit nga një lloj në tjetrin ose krijimit të një lloji të ri. Megjithëkëtë, veçanërisht neodarvinistët pretendojnë se, ndryshimet në sasi, me kohë, kthehen në ndryshime në cilësi, gjë që do të thotë një transformim. Së pari, a i mjafton jeta një individ të gjallë që tek ai të

ndodhë një ndryshim i tillë cilësor? Megjithëse s'ka asnjë dyshim se nuk i mjafton, le ta supozojmë të kundërtën dhe, në këtë rast, të bëjmë pyetjen: Ndryshimet cilësore që do të ndodhin, a do të jenë të dobishme, a do t'i përftojnë atij individ veti më të larta? Shkenca e gjenetikës ka vërtetuar se kjo s'është e mundur, se ndryshimet cilësore gjenetike të shkaktuara te një individ i gjallë janë regressive e të dëmshme, se ato sjellin deformime organesh dhe brezi dhe se nuk ka ndodhur e kundërta, domethënë që të jenë progresive e të dobishme.

Edhe kërkimet që bëhen sot, në ditët tona, mbi neoplazmat (kancerin), i japin rëndësi veçanërisht kësaj çështjeje dhe supozohet se ndikimet e jashtme si rrezatimet, papastërtitë e ajrit, etj., prishin qelizën dhe bëhen shkak për shfaqjen e neoplazmave. Ndërkaq, për sa kohë që vazhdojnë të bëhen kërkime jo vetëm në gjallesa të larta, por edhe në mikroorganizma, nuk janë vërtetuar ndryshime të tilla që të çojnë në një lloj të ndërmjetëm ose të ri. Për vite të tëra u bënë prova dhe kërkime mbi mizën *Drosophila* dhe u prodhuan pasardhës pak të ndryshëm të rreth 400 mizave. Megjithëkëtë, studimet mbi brezin e dytë të këtyre pasardhësve, të krijuar nga kryqëzimet mes tyre, nuk kanë zbuluar ndonjë lloj të ndërmjetëm apo të ri!

Shkurt, provat e bëra mbi mëse 400 miza *Drosophila* kanë treguar se me mutacione mund të ndodhin ndryshime të parëndësishme, por jo cilësore. Te këto miza kanë ndodhur ndryshime të tilla siç ndodhin tek njerëzit, siç janë errësimi i ngjyrës dhe ngritja e tensionit për shkak të kushteve klimatike, por jo ndryshime lloji dhe as breza të një lloji të ri nga kryqëzimi mes tyre, veçse miza *Drosophila* të sëmura apo të gjymtuara.

Njeriut i është njohur, në një masë të caktuar, e drejta dhe kompetenca për të ndërhyrë në natyrë dhe në gjërat. Si zëvendës i Zotit mbi tokë, për ta ndryshuar, rregulluar, sistemuar dhe urbanizuar sipërfaqen e tokës, ka qenë e domosdoshme që njeriu të zbulojë shkencat dhe mjetet për t'u bërë i aftë për këtë ndërhyrje. Veçse kjo ndërhyrje nuk vepron mbi kafshët për ndryshimin e llojit të



tyre. Ndryshime lloji mund të sillen vetëm tek bimët me anë të shartimit dhe vetëm te disa bimë të caktuara, kurse tek kafshët mund të bëhen vetëm përmirësime racore brenda të njëjtit lloj duke kryqëzuar në mënyrë natyrale ose artificiale raca të ulëta me individë të zgjedhur të racave të larta.

Si përjashtim i kësaj, te kafshët, Zoti ka lejuar kryqëzimin, për shembull, të kalit me gomarin, domethënë, i ka krijuar këto kafshë me këtë mundësi kryqëzimi. Ndërkaq, mushka e dalë nga një ndërhyrje që mund të quhet në botën e kafshëve përjashtim, është një kafshë pa mundësi fekondimi. Kjo do të thotë se nga një kryqëzim i tillë i llojeve të ndryshme lind një kafshë shterpë, pra, nuk mund të pritët që prej saj të shfaqet në botë një lloj i ri. Jashtë këtij lloj përjashtimi, nuk ka ndodhur që të krijohet një kafshë e re si përfundim i mutacioneve të njëpasnjëshme të shtrira në një kohë tepër të gjatë. Në disa kafshë mbi të cilat janë bërë kërkime, janë shfaqur ndryshime të tilla si, p.sh. një këmbë më e shkurtër ose ngjyrë tjetër qimeje, por lloji nuk ka ndryshuar, ai ka ruajtur origjinën e vet; ujku ka mbetur ujk e, delja, dele. Ndërhyrjet as ujkun së kanë bërë dot dele e, as delen, ujk! Jo në kafshë të tilla komplekse, por edhe te gjallesat më të vogla si bakteret nuk është vërejtur ndonjë ndryshim për t'u shënuar. Bakteret të cilat shtohen duke bërë një ndarje në njëzet minuta, edhe pas mutacioneve brenda 60 mijë brezave, mes baktereve para 500 milion vitesh dhe baktereve të sotme nuk shihet ndonjë ndryshim. Po kështu, nuk shihet ndonjë ndryshim as mes fosileve të përcaktuara me moshë 1 miliard vjeç dhe kafshëve të të njëjtit lloj që vazhdojnë të jetojnë sot.

Një tjetër çështje është se palenteologët tërheqin vëmendjen që, për ta pranuar evolucionin, duhet të gjenden fosile të ndërmjetme. Mirëpo darvinistët pretendojnë se nuk ka nevojë për fosile të ndërmjetme, se një kafshë mund të kapërcejë menjëherë nga një lloj më i ulët në një lloj më të lartë. Për shembull, sipas tyre, nga veza e një zvarraniku veç kur ka dalë një zog! Përgjigje kësaj i japin gjenetistët, të cilët thonë se asnjë qenie nuk mund të ndryshojë menjëherë 1000 veti. Dr. Lecomte de Nouy thotë se “një kalë mund

t'i hedhë pesë thonj (thundra) vetëm në pesë milion vjet". Kështu, pretendimi se në një evolucion të tillë që kërkon miliona vjet, një ndryshim që duhet të ndodhë gradualisht, të ndodhë menjëherë, është thjesht një marrëzi. Po të thuhet se ndryshimi ndodhi dalëngadalë (pa u shfaqur) dhe u shfaq, pastaj, menjëherë, themi se është kusht që ndryshimi i dukshëm nuk mund të ndodhë kështu, por shkallë-shkallë; për shembull, gjersa të bëhet njëthundrak, kali duhet të kalojë fazat e ndërmjetme si katërthundrak, trithundrak dhe dythundrak, pra, këta lloj kuajsh duhet të kenë jetuar medoemos. Ndërkaq, ndryshimi në thonjtë (thundrat), gjithsesi, nuk mbetet i kufizuar vetëm në ta, sepse trupi funksionon si një e tërë. Për shembull, kjo mund të vërehet lehtë në përmirësimin dhe mbylljen e një plage. Pra, është e pamundur që të mos vërehet një ndryshim i tillë te kuajt. Shkurt, nga veza e zvarranikut nuk del zog. Një ndryshim me kapacitet sa qindra mutacione mund të rezultojë vetëm me vdekjen e kafshës në çast.

Në qeniet mikroskopike ndodh një ndarje dhe riprodhim shumë i shpejtë. Për shembull, bakteri *Escherichia coli* fillon të ndahet në minutën e 20 dhe vazhdon kështu në shumë seri. Miza *Drosophila* riprodhohet 30 herë në vit. Një vit i kësaj mize përkon me 1 milion vite tonat. Ndryshimi që mund të ndodhë në jetën njerëzore në 1 milion vjet, te *Drosophila* duhet të duket në 1 vit. Po qe se te kjo mizë do të ndodhë një ndryshim në një vit, pranojmë se një ndryshim mund të ndodhë te njeriu në 1 milion vjet. Mirëpo faktet tregojnë krejt të kundërtën. Disa paleontologë bëjnë fjalë për baktere dhe alga blu-jeshile që kanë jetuar në periudhat gjeologjike të Silurit dhe Permit që konsiderohen si periudhat e para gjeologjike. Në disa libra lexojmë se këto baktere ekzistojnë qysh prej 300 milionë vjetësh, kurse, në disa të tjera, qysh prej 50 milionë vjetësh dhe shohim se siç kanë qenë 50 ose 300 milionë vjet më parë, janë edhe sot. Disa, duke pretenduar se algat blu-jeshile kanë një dendësi që e hedh poshtë transformizmin, mund t'i kundërshtojnë këto që themi ne, por, sido që të jetë, ne po flasim për bakteret, për qeniet me aftësi ndryshimi shumë të shpejtë e të dendur, megjithëkëtë, që kanë mbetur siç kanë qenë

miliona vite më parë.

Te kafshët që u janë nënshtruar kushteve jetësore të ndryshme në parqet natyrore të ngritura në vende të ndryshme të botës dhe veçanërisht në kopshtet zoologjike, nuk ndodh ndonjë ndryshim i dukshëm me sy. Në laboratorë të ndryshëm bëhen përpjekje për të realizuar mutacione që do t'i hapnin udhë evolucionit, por s'po merret ndonjë rezultat. Ndërkaq, disa dukuri të pjesshme e të kufizuara që pretendohet se janë dukur ose arritur, burojnë, pa dyshim, nga veçoritë krijimore të llojeve mbi të cilat eksperimentohet, pra, që janë të përshtatshme për dukurinë në fjalë. Kurse një ligj si evolucionit, i cili kërkohet të merret si bazë për shpjegimin e qenies së gjallë dhe jetës, nuk mund të jetë dhe të mbetet i kufizuar në ngjarje të veçuara e përjashtimore, por ta përfshijë gjithë qenien e gjallë. Allahu ka vënë në gjithësi përjashtime për çdo ligj dhe rregull të përgjithshëm në mënyrë që njerëzit të mos kapen krejtësisht pas ligjeve dhe rregullave e të harrojnë Autorin e vërtetë, Krijuesin, Zotin. Megjithëkëtë, nuk mund të thuhet se në punimet laboratorike lidhur me evolucionin është hasur qoftë edhe në një ngjarje përjashtimore në këtë nivel.

Një pretendim tjetër lidhur me këtë çështje është dukuria e nxjerrjes së një hibridi nga bashkimi i dy llojeve të racave të ndryshme të quajtura allopoliploid duke e dyfishuar më parë numrin e kromozomeve të tyre. Për shembull, pasi t'i kemi dyfishuar kromozomet e rrepës dhe lakrës dhe ta kemi shartuar rrepën me lakër, mund të na dalë një varietet tjetër rrepe. Por kjo ndodh në botën e bimëve. Sa më lart të ngjitemi në botën e qenieve, vëmë re se aq më e pamundur bëhet një gjë e tillë. Kështu, kjo dukuri nuk haset te kafshët dhe njerëzit.

Dyfishimi i numrit të kromozomeve bëhet, në kushte normale, për shkak të shterpësisë së qenies së formuar si rezultat i kryqëzimit mes llojeve të ndryshme, siç është rasti i mushkës. Meqë një qenie e tillë nuk mund të bëhet as nënë, as baba, ia dyfishojmë numrin e kromozomeve. Por, siç u tha, edhe nëse kjo është një dukuri që ndodh në botën e bimëve, tek kafshët nuk ndodh kështu.

Numri i kromozomeve te njeriu është 46. Janë këto 46 kromozome që përcaktojnë identitetin biologjik të njeriut. Megjithëkëtë, edhe sikur ky numër të ndryshohet, për shembull, të bëhet 45, 44 ose 47, 48, 49, etj., përsëri do të formohet një njeri e jo ndonjë qenie e ndonjë lloji tjetër, vetëm se një njeri me shtrembërime dhe të meta, pra, ndryshimi i numrit të kromozomeve bëhet shkak i anomalive. Prandaj, po qe se do të dyfishohej numri i kromozomeve të njeriut, qenia që do të lindte do të ishte përsëri njeri, vetëm se ky njeri do të lindte i vdekur ose do të vdiste pasi të lindte meqë nuk do të mund të jetonte. Kurse kur ndryshimi i numrit të kromozomeve nuk shkakton vdekjen, shkakton anomali të ndryshme si gjymtime e sëmundje të cilat e bëjnë gjithashtu të vështirë apo të pamundur jetesën. Prandaj, pasoja e lojës me kromozomet në botën e kafshëve dhe njerëzve është vetëm fatkeqësi.

Kështu, pra, meqë mutacioni është në themel një ndërhyrje në sistemin e ADN-së së qenies së gjallë, shfaqet te ajo me ndikime shkatërruese. Për rrjedhojë, nuk mund të bëhet fjalë për një mutacion të dobishëm me pasoja ndryshimesh serioze.

Mëshiruesi i Pafund, ashtu siç e ka vendosur informacionin gjenetik çift, edhe kodin e shumë aminoacideve, për shkak sigurie, e ka krijuar çift. Gjenetika është krejt si një gjuhë; pa u lexuar drejt për t'u përkthyer dhe shndërruar në proteina, nuk vlen për asgjë. Prandaj për jetën dhe shëndetin, sa çështë i nevojshëm informacioni gjenetik, është e nevojshme që, gjatë gjithë jetës së gjallesës, ky informacion të kthehet në proteina në kohën e duhur, saktë dhe në masën e duhur. Mirë, po çështë ajo gjë që lejon përdorimin e një pjese të informacionit që përmbajnë kromozomet të cilat janë si vëllime enciklopedike, ndërsa pengon përdorimin e një pjese tjetër të informacionit? Në përfundim të kërkimeve shkencore, është parë se disa proteina kryejnë funksionin e hapjes dhe leximit të informacioneve të caktuara, ndërkaq, funksionin e mbylljes dhe kyçjes së informacioneve të tjera të caktuara. E thënë ndryshe, informacioni gjenetik deshifrohet me anë të një serie molekulash proteinike dhe përdoret në sintezën proteinike, kurse proteinat

e sintetizuara përcaktojnë se kur dhe në ç'mënyrë do të lexohet informacioni gjenetik. Nga kush e marrin, vallë, këto, urdhrin e parë që i orienton për veprime të tilla, zbulimin e të cilave njeriu, qenia e vetëdijshme dhe e informuar, e ka konsideruar si suksesin e vet më të madh? Dhe si arrijnë ta kontrollojnë më pas programin gjenetik nga ku e kanë marrë informacionin e duhur për t'u vetëprodhuar?

Urdhrin dhe komandimin me anë të një programi të veçantë misterioz mund ta shohim edhe në ngjarjet e rigjenerimit. Është shumë e habitshme se si te disa kafshë, pasi ndonjë organ u plagoset, dëmtohet apo këputet, nis një proces rigjenerimi që duket si diçka krejt e zakonshme, por që është tejet e jashtëzakonshme dhe e mrekullueshme. Qelizat e vendit të këputur ose të dëmtuar të një organi çfarëdo, gjer në atë çast kanë qenë qeliza normale të trupit, por të specializuara për një vend dhe funksion të posaçëm. Pastaj si ndodh që këto qeliza marrin një funksion të ri, atë të riprodhimit të organit të hequr në një farë mënyre, të riprodhimit të të gjitha llojeve të indeve që e përbëjnë atë organ si dhe organin në tërësi? Përse dhe si vihet në veprim një funksion dhe lëvizje e tillë? Kush e ndjen një nevojë të tillë? Meqë është krejt e pamundur që qelizat të jenë të vetëdijshme për një gjë të tillë dhe meqë në trup dhe në natyrë nuk ekziston ndonjë qendër që t'u japë qelizave një informacion të tillë dhe mekanizmën me anë të së cilës do të kalonin në veprim duke e përdorur atë informacion, do të thotë se është dikush që i di të gjitha nevojat e trupit (për kafshën përkatëse) dhe zotëron mundësitë e duhura për t'i plotësuar ato nevoja, që i kryen këto punë në kohën dhe vendin e duhur!

### **Pretendimi mbi pemën gjenealogjike dhe pema (gjenealogjike) e qenies**

Edhe fati i pemës gjenealogjike mbi të cilën evolucionistët, në emër të teorive të parashtruara prej tyre, qëndrojnë me këmbëngulje, është mjaft i ngatërruar. E para, zbulimet e reja në biologjinë

molekulare kanë krijuar probleme të reja të pazgjidhshme dhe gjendje pa rrugëdalje për teorinë e evolucionit, për ç'shkak mund të themi se e kanë shtrënguar atë në qoshe, sepse në “pemët gjenealogjike” të sajuara duke marrë për bazë grupe molekulash të ndryshme, kanë dalë në shesh rezultate krejt të ndryshme duke u bërë krejt e pakuptueshme se cili është prejardhur prej cilit dhe pse është prejardhur. Megjithëkëtë, evolucionistët flasin për pretendimin e tyre, sipas të cilit “mund të vizatojnë pemë gjenealogjike shumë të ndryshme sipas uniteteve molekulare biologjike të ndryshme të marra nga grupe kafshësh të ndryshme e të pranuar si themel”. Por, duke vepruar kështu, në të vërtetë, ata, duke e pranuar në fillim evolucionin si një të vërtetë të qëndrueshme dhe, pastaj, duke e radhitur materialin që kanë në dorë mbi këtë bazë, dashje pa dashje pohojnë se vizatojnë një pemë gjenealogjike iluzive. Veçanërisht, edhe pretendimi i evolucionistëve se rrënjët e pemës gjenealogjike të qenies janë tjetër, trugu, tjetër, degët dhe frutat, tjetër, nuk është i drejtë. Krejt e kundërta, kërkimet dhe studimet e bëra kanë treguar se qeniet e quajtura rrënjë, trung, degë e fruta jetojnë së bashku në të njëjtën kohë!

Për shembull, në periudhën e Kembrienit janë shfaqur dhe kanë jetuar së bashku shumë gjallesa që evolucionistët ia përkatësojnë asaj periudhe duke i konsideruar në raporte atësie e birësie ndaj njëri-tjetrit! Po kështu, është e evidente se një sërë qeniesh të thjeshta e të ulëta kanë jetuar së bashku në të njëjtën periudhë me qenie shumë komplekse. Kjo do të thotë të pranosh se mund të gjenden së bashku në të njëjtin çast, stërnipi me gjyshin e vet të njëqind mijë brezave të mëparshëm, gjallesa komplekse të parashikuara se kanë jetuar në një periudhë me gjallesa të thjeshta e të ulëta për të cilat pretendohet se i përkasin një periudhe miliarda vjet më parë. Tjetër, një sërë gjallesash detare që jetojnë sot, nga më të ulëtat e periudhës së Devonienit gjer te peshkaqeni, janë shfaqur menjëherë dhe së bashku në atë periudhë dhe, pastaj, duke kapërcyer kulmet e kohëve, kanë ardhur gjer në ditët tona, gjë që është krejt e pamundur të shpjegohet me pretendimet e evolucionistëve. Për shembull, fakti se, ndërsa pretendohet se brezi i peshqve të

grupit *Crossopterigi* që janë nga gjallesat e periudhës në fjalë dhe që, sipas mendimit evolucionist, konsiderohen si ati i bretkosave, është konsumuar 70 milion vjet më parë, ato janë dukur në tufa të hapësirat detare të Afrikës së Jugut, fakti se është zbuluar që në periudhën e karbonifereve kanë jetuar së bashku bretkosat me zvarranikët, çështje e drejta, është e pamundur të kuptohen sipas teorisë evolucioniste dhe secili prej këtyre fakteve janë goditje vdekjeprurëse për mendimin evolucionist që pretendon se zvarranikët kanë ardhur nga bretkosat.

## SELEKSIONI NATYROR OSE PËRZGJEDHJA NATYRORE

Njëra prej teorive të sajua nga evolucionistët për të mbështetur teorinë e tyre evolucioniste është seleksioni natyror ose shqip, përzgjedhja natyrore. Sipas tyre, fatkeqësitë e ndryshme, përmbytjet, shembjet, karakteri persekutues dhe shkatërrues i dukurive dhe ngjarjeve i marrin me vete qeniet pa qëndresë dhe pas mbeten qeniet e fuqishme e të qëndrueshme.

Para së gjithash, nuk e di se sa është e mundur të ngrihet lidhje mes kësaj dhe evolucionit, sepse nuk ka ndonjë shenjë se gjallesat e mbetura në këmbë pas këtyre lloj fatkeqësive kanë ndërruar lloj. Edhe nëse thuhet se, me kohë, disa lloje kafshësh janë asgjësuar, nuk mund të thuhet as se fosilet e tyre kanë dalë në shesh si lloje të reja, as se llojet që kanë mbetur pas ose individët e fuqishëm të mbetur gjallë pas ndonjë fatkeqësie janë hedhur në një lloj tjetër më të lartë. E dyta, brenda çdo lloji gjallesash ka edhe të fuqishëm, edhe të dobët që rrojnë së bashku, ndërkaq që pas këtij fakti fshihen urtësi të jashtëzakonshme të Zotit. Ushqimi me mish i disa llojeve formon në natyrë një zinxhir ushqimor, në sajë të të cilit realizohet dhe vazhdon sistemi ekologjik. Po të mos ishte dhe ndodhte kështu, pra, po qe se të gjithë individët e të gjitha llojeve të kafshëve mishngrënëse do të ishin të fuqishëm sa të mos binin pre e njëri-tjetrit, kafshët mishngrënëse do të asgjësoheshin, kurse kafshët e tjera do të shtoheshin në mënyrë të jashtëzakonshme duke e tronditur nga rrënjët ekuilibrin ekologjik. Kjo dukuri e vërejtur në botën e kafshëve është një faktor i rëndësishëm që u jep mundësi llojeve që kanë për ushqim individët e dobët të llojeve të tjera ta vazhdojnë ekzistencën e tyre.



Këtu duhet shënuar edhe se asgjësimi i individëve të dobët të një lloji nuk bën që brezat e ardhshëm të atij lloji të dalin vetëm me individë të fuqishëm ose përgjithësisht më të fuqishëm. Në çdo brez do të ketë gjithmonë të fuqishëm e të dobët dhe, përsëri, individët e dobët, të plakur dhe ata që nuk mund ta përballojnë jetesën e tufës, bëhen ushqim për kafshët mishngrënëse e të egra, kurse lloji do të vazhdojë në rrugën e vet të jetës.

Duke u nisur nga kjo, themi se duke e konsideruar jetën si identitet të luftës për ekzistencë dhe duke e përgjithësuar një ngjarje të vetme për jetën e të gjitha gjallesave (kafshëve), evolucionistët dhe natyralistët kanë kryer një krim të madh. Sipas tyre, qëllimi i vetëm i jetës është mbetja gjallë, prandaj dhe përbëhet nga gjetja dhe sigurimi i ushqimit. Evolucionistët, natyralistët dhe materialistët që e kanë vlerësuar po kështu edhe jetën e njeriut, e kanë parë pothuaj si një të drejtë të natyrshme mbetjen gjallë të të fuqishmëve në dëm të të dobëtëve, qëllimin final të jetës së njeriut e kanë kuptuar si ushqyerje dhe riprodhim, për rrjedhojë, edhe e kanë legjitimuar shfrytëzimin mes njerëzve dhe kombeve duke ia prerë rrugën ndihmës reciproke, edhe njeriun, duke e zhveshur prej të gjitha vlerave të larta që bart, e kanë zbritur në një nivel të ulët, madje nën kafshët. Mirëpo në jetë lufta është aksidentale, kurse ndihma reciproke, esenciale. Bota qëndron në këmbë në saje të ndihmës reciproke mes të gjitha qenieve. Ajo që i bie njeriut për detyrë, është ta bëjë tokën jo arenë lufte, përleshjeje e grindjeje, por djep ndihme reciproke dhe vëllazërie. Kurse evolucionistët e paraqesin çështjen krejt ndryshe, pra dhe s'mund të thuhet se s'janë fajtorë për fatkeqësitë mbarëbotërore të 1-2 shekujve të fundit, si luftërat dhe revolucionet; ata i shohin si "të natyrshme" tragjeditë, kolonializmin ndërkombëtar, tregtinë e skllëvërve, dallimin racor dhe sundimin e forcës mbi të drejtën që njihen në histori, pra dhe nuk mund të thuhet se s'i legjitimojnë këto. Me të vërtetë, themeluesi i komunizmit, Karl Marksi, që e ka ngritur dhe mbështetur teorinë e vet historike mbi këtë themel, i detyrohet shumë Darvinit dhe nuk është e rastit që komunistët janë, ndër materialistët, apologjetët më të pasionuar të evolucionit. Sepse evolucioni është

edhe një nga mbështetjet themelore të ateizmit. Fundja, në një masë të madhe si rrjedhojë e këtyre faktorëve evolucioni mbahet me këmbëngulje në rend të ditës në mjediset shkencore dhe dëftohet si dogmë, si ideologji. Por sa e çuditshme dhe kontradiktore është që të njëjtat mjedise, shpesh ose përgjithësisht, e paraqesin veten si kampionë të mbrojtjes së të drejtave të njerëzve, të të shtypurve, të lirive themelore e, veçanërisht, të lirisë së mendimit, të paqes së përgjithshme duke mos i lëshuar vend askujt tjetër!

Në kundërshtim me pretendimet e evolucionistëve mbi seleksionin natyror, fatkeqësitë e mëdha e të papërmbajtshme, si përmbytjet, tërmetet, shembjet, etj., marrin me vete, krahas të dobëtëve, edhe të fuqishmit. Nga ana tjetër, në kuadrin e artit, ligjshmërisë dhe veprimtarisë ekzekutive të Allahut, ka miliona vite që të dobëtit jetojnë pranë e pranë me të fuqishmit dhe që, për rrjedhojë, ka miliona vjet që ekuilibri ekologjik, harmonia dhe përsosmëria në natyrë vazhdojnë të ekzistojnë dhe veprojnë pa marrë asnjë plagë.

Sot, paleontologjia, në kundërshtim me mendimin evolucionist, thotë se qysh në krye të herës kanë jetuar së bashku njëqelizorët të konsideruar si qenie primitive me bretkosat, zvarranikët, zogjtë dhe gjitarët si qenie mjaft komplekse.

Për shembull, fosilet bimore si *Neoplina* që pretendohet të jetë fshirë nga ekzistenca me anë të përzgjedhjes natyrore 300-400 milion vjet më parë, *Coelacanth* që pranohet të ketë jetuar 70 milion vjet më parë, *Crinoid* që thuhet se ka jetuar 565 milion vjet më parë, *Limulus* që konkludohet të ketë jetuar 225 milion vjet më parë dhe *Gunt-Flinti* 2 miliard vjeçar e qindra të tjerë që jetojnë ende sot, janë dëshmitarë të faktit se evolucioni nuk ka vend as në tokë e as në qiell. Duke e pohuar këtë, një sërë evolucionistësh të moderuar nuk ngurrojnë të thonë se grupe të mëdha kafshësh të larta si peshqit, zvarranikët dhe gjitarët janë shfaqur në tokë përnjëherësh.

Shkurt, edhe përzgjedhja natyrore që përdoret shpesh si argument në evolucion, sështë gjë tjetër veç një hipotezë e dobët, e

paqëndrueshme dhe e errët. Vëzhgimet shkencore nuk kanë vërtetuar as fshirjen e të dobëtëve prej llojit për shkak të rrethanave dhe as zotërimin e të fuqishmëve mbi jetën duke sjellë përmirësimin e të dobëtëve, siç pandeh mendimi evolucionist. Për rrjedhojë, ajo çka dëgjohet në gjoksin e qenies nuk janë vetëm qeshjet e të fuqishmëve dhe rënkimet e vdekjes së të dobëtëve. Edhe nëse në historinë e njeriut hasen herë pas here pamje të tilla, e përgjithshmjia karakterizohet nga sundimi i të drejtës, dhembshuria dhe mëshira e të pasurve për të varfrit dhe të dobëtit, ndjenja e falënderimit të të varfërve dhe të të dobëtëve për të pasurit dhe të fuqishmit. Kjo ka përbërë vijën historike të njerëzimit dhe në këtë vijë ka ardhur historia e njerëzimit gjer në ditët e sotme.

## MATERIA, RASTËSIA DHE PRETENDIMET E VETËKRIJIMIT

Në themel të evolucionit qëndron pretendimi se qenia ekziston vetvetiu dhe e varur nga rastësitë.

Ati i evolucionizmit para Darvinit, Lamarku, e konsideronte evolucionin si një mundësi të dhënë nga Zoti materies dhe natyrës. Ai ishte evolucionist që pranonte gjenezën hyjnore të materies. Në kundërshtim me të, Darvini e mbështet ekzistencën e materies në vetë aftësinë e saj për të ekzistuar dhe zhvilluar. Ata që erdhën pas Darvinit, ranë plotësisht në materializëm dhe mohim dhe zgjodhën rrugën për ta përdorur evolucionin si mbështetje për mohimin e Zotit.

Ata që i dalin sot për zot darvinizmit, janë bota materialiste që mbahen pas tij në emër të mohimit. Këta besojnë në eternitetin e materies, pra, në pafillimshmërinë dhe pafundshmërinë e materies.

Duhet theksuar qysh në fillim që evolucionistët, dashje pa dashje, përfytyrojnë një hapësirë të pafundme, sepse t'i japësh eternitet materies dhe ta vendosësh evolucionin, brenda këtij eterniteti, në një kohë me fillim të papërcaktuar, do të thotë t'i japësh hapësirës pafundësi meqë koha dhe hapësira nuk mund të mendohen veç e veç. Koha ka një ekzistencë nominale (konvencionale); është hapësira që e bën atë një dimension të materies dhe dukurive. Nuk mund t'i jepet ekzistencë kohës në mungesë të hapësirës. Ndërkaq, hapësira përbëhet prej botës së atomeve, botës së lëndës. Për rrjedhojë, po qe se vërtetohet se lënda nuk është eternale (e pafillim dhe e pafund), do të dalë në shesh se edhe hapësira dhe koha nuk janë eternalë dhe do të kuptohet vetvetiu se një gjë që s'është eternale

nuk mund të jetë krijuese dhe e vetëkrijuar.

Ligji II i termodinamikës i njohur, tashmë, nga shumica, e hedh poshtë eternitetin e lëndës dhe materies. Ligji I i termodinamikës është ligji i ruajtjes së energjisë, kurse Ligji II është ligji i njohur Carnot. Sipas tij, nxehtësia e qendrave të nxehtësisë, duke u përhapur e përhapur pa pushim, një ditë do të konsumohet dhe niveli i energjisë në gjithësi do të barazohet, do të bëhet i njëjllotë kudo. Edhe nëse kjo nuk do të thotë asgjësim i energjisë, do të thotë asgjësim i diferencës plus-minus dhe vdekje. Carnot e parashtroi këtë ligj duke u mbështetur në vëzhgimet në shtëpinë e vet mbi shpërndarjen e energjisë nga soba dhe uji i zjerë. Pastaj vëzhgimet e tij u zhvilluan më tej nga shkencëtarët, u përgjithësuan në një ligj i cili mësohet sot nëpër shkolla.

Sot është e pamundur të thuhet ndonjë gjë e prerë mbi ndikimin e përgjithshëm të termodinamikës mbi gjithësinë. Megjithëkëtë, mund të thuhet se gjithësia sështë një e tërë, por e përbërë prej pjesësh (copash), ndërkaq që konkluzioni mbi një copë është i vlefshëm edhe mbi të tërën. Vëzhgimet e kësaj fushe tregojnë se po të mos shpërthejë më parë një katastrofë e përgjithshme për ndonjë shkak tjetër, katastrofa termodinamike është absolutisht e pashmangshme, domethënë, energjia në gjithësi do të konsumohet dhe sistemi do të shembet. Këtu mund të pyetet mbi marrëdhënien e katastrofës termodinamike me joeternitetin e lëndës dhe materies ose ç'dëm do të pësojnë koha dhe hapësira që pretendohet se janë eternale.

Le ta bëjmë të qartë në fillim se ata që i japin materies eternitet, duket sikur nuk e dinë se ç'do të thotë eternitet. Sikur të gjitha kokrrat e rërës që ekzistojnë mbi tokë t'i bëni zero dhe në krye të vargut me zero që do të formohet, të vendosni një njësh, shifra e frikshme që ka për të dalë, në raport me eternitetin do të ketë vlerën zero. Po si kjo, përballë eternitetit, numri më i madh që do të mund të mendonte, konceptonte dhe prodhonte mendja e njeriut, do të ishte përsëri zero! Sepse eternal do të thotë i pafund. Gjëja e pafund:

1) Nuk mund të jetë e përbërë, nuk mund të hyjë në sintezë. Ajo është e thjeshtë dhe e pandashme (e pacopëtueshme).

2) Nuk ndryshon kurrë dhe mbi të nuk mund të vepohet.

3) Ndodhet e pavarur nga koha dhe hapësira, pra, jashtë lëvizjes së varur nga koha dhe hapësira.

4) Është absolutisht e pafundme sepse është absolutisht jashtë kohës.

Nga ky këndvështrim, meqë pafillim dhe pafundësi do të thotë pakohësi, pafillimi dhe pafundësia takohen në një pikë. Asnjë prej këtyre veçorive nuk ndodhen te materia. Materia është e ndryshueshme; siç e ka treguar edhe ligji i termodinamikës, materia nuk mund të mendohet veç energjisë e cila një ditë ka për ta humbur krejtësisht ndikimin e vet. Veçanërisht, materia është e hapur ndaj çdo lloj sinteze. Ndërkaq, materia është e varur nga koha dhe hapësira. Apologjetistët islamë thonë, duke e pasur fjalën për Zotin, “po qe se një gjë është në mënyrë evidente e pafillimtë, asgjësimi i saj është i pamundur”. Me këtë, ata tregojnë se materia kurrë nuk mund të bëhet burim ekzistence dhe pohojnë veçoritë individuale të Individualitetit të i cili mund të mbështetet materia.

Hapësira përbëhet, në përmasa të vogla, prej atomeve, kurse në përmasa të mëdha, prej diejve. Në diellin tonë që është vetëm njëri prej këtyre diejve, shndërrohen 564 ton hidrogjen në helium në sekondë dhe, si rezultat i këtij shndërrimi, përreth përhapet një energji prej miliona kalorish në formë nxehtësie dhe drite. Një pjesë e kësaj energjie që shpërndahet në tërë sistemin diellor, vjen edhe në globin tonë tokësor. Gjithësia përbëhet prej diejsh të tillë. Dielli ynë një ditë do të arrijë pikën e konsumimit dhe atëherë do të ndodhë një katastrofë planetare.

Meqë gjithësia përbëhet prej këtyre diejve që janë si gurë themeli për të, nuk mund të mendohet që këta diej, energjia e të cilëve shkon drejt konsumimit, të jenë eternals, sepse, siç u tha edhe më lart, gjëja eternals (e pafundme) nuk mund të jetë e përbërë,

nuk varet nga koha dhe hapësira, nuk konsumohet, nuk pëson as ndryshimin më të vogël. Kurse ne shohim se materia dhe bota materiale janë në ndryshim të vazhdueshëm, se kalojnë nga një gjendje në një tjetër, shpërbëhen (analizohen) dhe përbëhen (sintetizohen) ose bëhen orbitë. Në këto kushte, materia ka edhe fillim, edhe fund dhe është e kufizuar nga koha dhe hapësira. Çdo pretendim jashtë kësaj është i detyruar të mbetet një hipotezë pa asnjë pjesë të vërtete. Vetë Darvini, duke e shprehur dobësinë e vet në lidhje me këtë çështje, thotë: “Në fakt, meqë nuk u ndodha në periudhën kur kanë jetuar këto qenie, jam i detyruar ta përforcoj çështjen me një sërë hipotezash!”

Sado që të mbështetet në një sërë dijesh paraprake, në themel, hipoteza përbëhet prej pikëpamjesh dhe pretendimesh të paprovuara. Po qe se Darvini ka hedhur në shesh një hipotezë, edhe unë hedh në shesh hipotezën time dhe them se, me një lëvizje të tokës, njeriu u hodh 10 mijë metra përjetë dhe s’i ndodhi asgjë. Edhe kjo është një hipotezë. Ndërkaq, po qe se ju më dilni kundër duke thënë se njeriu i ngjitur në lartësinë 10 mijë metra vdes në çast nga mungesa e oksigjenit, unë e mbështes këtë hipotezë me një hipotezë tjetër dhe them se “ju flisni sipas kushteve të sotme, kurse kushtet tokësore në një periudhë tjetër kanë qenë të ndryshme”. Po qe se hipoteza ime nuk është shkencore por vetëm një pretendim, edhe pretendimet e Darvinit dhe darvinistëve nuk kanë ndonjë ndryshim! Pretendimi evolucionist s’është gjë tjetër veçse një hipotezë që e përgënjeshtrojnë të gjitha ligjet vepruese në gjithësi e në jetën e gjallë, që i mbush boshllëqet që i shfaqen, me hipoteza të tjera.

## A ËSHTË E MUNDUR RASTËSIA DHE A MUND TË SHPJEGOHET EKZISTENCA E SAJ?

Ata që përpiqen ta mbajnë teorinë e evolucionit vazhdimisht në rend të ditës sikur të ishte një e vërtetë shkencore, pretendojnë, duke u mbështetur te provat dhe eksperimentet e Milerit, se, në një periudhë të caktuar të tokës, në fund të detit janë krijuar grumbuj proteinash, se, si rezultat i reaksioneve kimike, janë formuar aminoacide, se, të gjitha këto, kanë ndodhur vetvetiu, por nuk e marrin parasysh pohimin e Oparinit, i cili, pas 20 vjet përpjekjesh të vazhdueshme në laboratorët mundësisht më të përsosura për të sintetizuar një qelizë të gjallë, tha: “Është e pamundur që, edhe në laboratorët më të përsosura, të bëhet një qelizë e gjallë vetëm me anë të elementeve kimike!” Mbetet të themi se llogaritet që vetëm për formimin rastësor të një aminoacidi ose molekule proteinike, duhet një kohë që e kapërcen disa herë moshën e tokës. Atëherë, nëse moshja e sotme e tokës nuk mjaftoka për formimin rastësor të një aminoacidi ose molekule proteinike, si mund të jetë e mjaftueshme për formimin e një qelize të gjallë?

Në fakt, jeta mbi tokë varet nga shumë ekuilibra dhe kushte. Më së pari, globi tokësor mbi të cilin jetojmë, duhet t'i përmbajë të gjitha kushtet në të cilat ndodhet. Ne jetojmë mbi një trup qiellor që ndodhet 149.5 milion km. larg nga dielli ynë. Vetëm kjo largësi, madje, kurrësi nuk mund t'u dedikohet rastësive. Toka është e prirur 23.5 gradë ndaj vertikales. Edhe kjo prirje që është shkaku më i rëndësishëm në formimin e stinëve, nuk mund t'u dedikohet rastësive. Gjithashtu, fakti që 21% të atmosferës e përbën oksigjeni, nuk mund të shpjegohet me rastësinë. Po që se me llogaritje të mbështetura në probabilitet, pranojmë se pasi një i verbër të hedhë



në tokë një gjilpërë, maja e gjilpërës së dytë që do të hedhë, do të ketë 1% probabilitet për të hyrë në vrimën e gjilpërës së parë, mund të themi se matematika ende nuk e njeh shifrën që do të përbënte përqindjen e hyrjes së 1000 gjilpërave që do të hidhte i verbëri, në vrimat e njëra-tjetrës. Kurse do të duhej një shifër shumë herë më e madhe për të shprehur probabilitetin e ardhjes së gjithësisë dhe tokës në gjendjen e sotme me anë të rastësive. Ta pranosh një gjë të tillë jo vetëm sështë një qëndrim shkencor, por as diçka që e pranon mendja. Për këtë, James Jeans thotë kështu:

*“Vetëm për ta kuptuar probabilitetin e ardhjes së tokës në formën që ka tani, merrni në dorë të gjithë rërën e tokës dhe shpërndajeni. Sa të ketë probabilitet që çdo kokërr rëre të zërë vendin e njërit prej elementëve që përbëjnë tokën dhe e gjithë masa e rërës të marrë rastësisht formën që ka toka sot, aq ka probabilitet që toka ta ketë marrë formën që ka sot me anë të rastësive!”*

Jeta në tokë nuk varet vetëm nga forma që ka sot dhe nga largësia prej 149.5 milion km. nga dielli. Dendësia e atmosferës, thithja prej saj e rrezeve të diellit, djegia e plotë e meteorëve në të pa arritur të bien mbi tokë janë një çështje më vete. Thithja e gazrave nga toka dhe e gazrave helmuese nga detet është një çështje më vete. Marrëdhëniet mes bimëve dhe kafshëve, fakti që bimët natën nxjerrin dioksid karboni, kurse ditën e thithin, dukuria e domosdoshme e fotosintezës për bimët, fakti që për t’u bërë mollë një farë molle, duhet t’i përmbajë të gjitha informacionet e procesit të rritjes, prodhimit dhe marrëdhënieve me tokën, diellin, lagështirën dhe ajrin janë edhe këto një çështje më vete. Përgjithësisht, toka dhe jeta në të kërkojnë një mekanizëm të përsosur, dije, vullnet, vetëdije dhe fuqi, prandaj dhe t’ia dedikosh jetën rastësisë së verbër, do të thotë të heqësh dorë nga arsyeja dhe njerëzoria.

Në lidhje me këtë çështje, nëse edhe njerëzit më optimistë janë të mendimit se, për formimin e një vargu aminoacidi vetëm si kohë nuk do të mjaftonte jeta e tokës, atëherë njeriut i vjen të pyesë: Mos vallë evolucioni nisi në botën tjetër dhe i dha frytet në këtë botë? Po qe se sështë kështu, me ç’rrugë e fitoi kjo qenie e

shkëlqyer këtë bukuri marramendëse dhe madhështi që ka sot duke lënë pas kaos? Si arriti jeta të ekzistonte duke iu kundërvënë rikthimit pas? Si u shfaqën vetvetiu miliona gjallesa që ekzistojnë sot? Si ndodhi që gjërat, në kundërshtim me ligjin e II të termodinamikës, i kapërcyen një nga një të gjitha pengesat dhe kaluan nga gjendja e thjeshtë në gjendje të përbërë, nga gjendja e zakonshme në gjendje arti? A mund t'u përgjigjemi të gjitha këtyre në përputhje me frymën e shkencës? Apo do të bëjmë si disa që, duke u ikur të vërtetave shkencore, thonë se evolucioni është fakt i kryer, nuk ka nevojë për vërtetim?

Në të vërtetë, dituria dhe shkenca hapin portat e besimit dhe e çojnë njeriun te Allahu, Zoti i gjithësisë. Kurse dituria dhe shkencat që s'kanë arritur pjekurinë, dhe, veç kësaj, përzihen me krenari, vetëpëlqim, pikëpamje të gabuara dhe dhunë e padrejtësi, çojnë në perversitet dhe mohim.

## VETEKZISTENCA

Teoricienët evolucionistë, meqë nuk e shpjegojnë dot kalimin në jetë, mbahen pas rastësisë dhe vetëkrijimit qysh në krye të herës. Sipas pretendimeve të tyre, në atmosferën tonë të parë kishte shumë amoniak, metan, avuj uji dhe hidrogjen. Këta, në sajë të zbrazjeve energjetike spontane me anë të rrufeve dhe shpërthimeve vullkanike, hynë në reaksione me njëri-tjetrin dhe formuan aminoacidet. Me kohë, duke iu nënshtruar një procesi purifikimi, aminoacidet u shndërruan në proteina të cilat ranë në ujëra dhe, kështu, u shfaqën qeniet e para në formë krimbesh dhe shushunjash.

### Eksperimentet e Milerit

Përkrahësit e evolucionit i përdorën eksperimentet e Milerit si argument se jeta mund të krijohet me anë të reaksioneve kimike. Mirëpo ajo çka bëri Mileri, ishte të eksperimentonte nëse mund të formohej një gjë e gjallë nga aminoacidet që zgjodhi posaçërisht nga njeriu si qenie me dije, vetëdije dhe vullnet. Në eksperimentet e tij ai pa se që të formohej gjallesë dhe ajo të mund ta vazhdonte jetën e saj, duhet t'i jepej vazhdimisht dhe në mënyrë të kontrolluar energji. Më e rëndësishmja, ishte një mekanizëm kurthi të ftohtë i përgatitur posaçërisht që i mbronte aminoacidet e zgjedhura nga copëtimi, i bashkonte bashkë dhe i grumbullonte. Nëse në aminoacidet ekziston mundësia për t'u shndërruar në gjallesë, për të përbërë truall për jetën - dhe kjo mundësi është e dhënë nga Zoti - këtë mundësi mund ta vërë në veprim njeriu si qenie me arsye, dije dhe vullnet. Kurse të pretendosh se të gjitha këto mund të ndodhin rastësisht, do të thotë të tallesh me arsyen, dijen dhe vullnetin!

## Autotrof, heterotrof

Evolucionistët pretendojnë se gjallesat e shfaqura vetvetiu apo rastësisht, mund ta sigurojnë energjinë e nevojshme për jetën nga dielli ose reaksionet kimike. Veçanërisht pretendojnë se mund të ushqehen si ameba ose t'i formojnë vetë lëndët ushqyese që u duhen. Ata përpiqen t'i mbështesin pretendimet e tyre me tezat e ushqyerjes autotrofe (vetëushqyerje) dhe heterotrofe (ushqyerje nga jashtë). Ushqyerja autotrofe sot nuk pranohet. Reaksionet kimike që formojnë ushqim, si fotosinteza, janë dukuri shumë të komplikuar. Kur i mendojmë reaksionet e komplikuar në bimët e blerta që mund të bëjnë fotosintezë dhe enzimat që marrin pjesë në ato reaksione, shohim se veçori të tilla si vartësia mes elementëve vepron në mënyrë të përsosur.

Evolucionistët janë zënë ngushtë nga fakti që një sistem i tillë i përsosur është formuar menjëherë në kushtet e para tokësore, sepse bie në kundërshtim me pretendimet e tyre evolucioniste. Reaksione të tilla komplekse mund të përftoheshin vetëm në mekanizma komplekse që duhet të jenë shfaqur menjëherë, së bashku me gjallesat në mënyrë që ato të mund të prodhonin ushqimin e duhur. Mirëpo kjo është e kundërt në themel me darvinizmin, sepse sipas darvinizmit është krejt e pamundur që një mekanizëm kompleks të shfaqet menjëherë. Mendimi evolucionist e kërkon që të gjitha këto të formohen gradualisht, dalëngadalë dhe një nga një.

Kurse sipas tezës së ushqyerjes heterotrofe, për gjallesën nuk ka ushqim të gatshëm, gjallesa nuk mund ta bëjë atë vetë, prandaj duhet ta marrë prej jashtë. Por edhe kjo e bën të domosdoshme ekzistencën e mekanizmave që do të bënin të mundur zhvillimin e reaksioneve shumë të komplikuar. Ushqimi që duhet të marrë një gjallesë duhet të jetë një lëndë organike e prodhuar gjithashtu nga një gjallesë. Për rrjedhojë, çdo gjallesë ose gjallesa e parë e shfaqur do të jetë nevojtare për ekzistencën e një gjallese tjetër para saj, gjë që shkon mbrapsht në mënyrë zinxhir duke i bërë edhe gjallesat eternale, pa fillim, gjë që është absurde dhe e pamundur!

## Ekzistenca dhe ligjet e saj

Mbetet të themi se në formimin e gjithësisë dhe të të gjithë elementëve në të, në formimin e qenieve të gjalla e jo të gjalla, ka një vetëdije, dije, parapëlqim, domethënë, vullnet krejt të hapur. Ndërsa shkencëtarët natyralistë dhe materialistë, nga njëra anë, ia lënë këtë proces formimi rastësisë dhe vetëformimit, nga ana tjetër bëjnë fjalë për ligjet. Mirëpo ligji e kundërshton edhe rastësinë, edhe vetëformimin. Gjithashtu, ligji mund të jetë vetëm vepër e dikujt që di.

## Renditja e proteinave dhe aminoacideve

Shkencëtari i njohur suedez, Charles Eugenie Guye thotë: “Një proteinë formohet nga 40 mijë atome. Për rrjedhojë, mundësia e vetëformimit të vetvetishëm të një proteine është një për 60 në fuqi të dhjetë.” Ndërkaq, s’duhet harruar se te qenia e gjallë nuk bëhet fjalë për një proteinë, por për vargje proteinash. Dhe për të formuar një varg proteinash, Dr. Lecomte de Nouy thotë pikërisht kështu: “Një varg proteinash mund të formohet rastësisht vetëm një për 243 në fuqi të dhjetë.” Por njeriu nuk përbëhet as nga një varg proteinash, as nga një qelizë! Njeriu përbëhet prej 60 trilion qelizash të cilat janë të lidhura në atë mënyrë me njëra-tjetrën, sa që disa herë, prishja e sistemit të vetëm njëres prej tyre mund të sjellë vdekjen e njeriut! Jeta e njeriut zhvillohet pikërisht mbi marrëdhënie kaq të ndjeshme dhe po kaq të përsosura! Kur e mendoni këtë sistem të mrekullueshëm, dëgjoni ndërgjegjen të thotë: *“Allahu ynë, pohojmë se Ti je larg çdo lloj kuptimesh të gabuara dhe të madhërojmë! Sa e madhe është fama jote!”*

Në formimin e një qenie të gjallë, në fillim bëhen ekzistente aminoacidet, pastaj proteinat. Aminoacidet renditen dhe formohet një proteinë. Që proteinat të formojnë një qenie të gjallë, është nevoja edhe e gjërave të tjera. Si një sistem molekulash e organizuar sipas një plani të caktuar, çdo qenie e gjallë, për t’u formuar si dhe për ta vazhduar jetën pas formimit, ka nevojë, bashkë me energjinë, edhe për t’u ushqyer. Biologjia evolucioniste pretendon

se gjallesa e parë e ka marrë këtë energji nga dielli dhe ka përfituar në mënyrë të veçantë edhe nga rrezet ultravjollcë si dhe nga vetëtimat. Kurse ne e dimë se gjallesa ka nevojë për energji në një masë të caktuar, në mënyrë të rregullt dhe pandërprerje si gjatë formimit, ashtu dhe pas formimit për ta vazhduar ekzistencën e saj. Ndërkaq, rrezet e diellit nuk ngrohin gjithmonë njëlloj, kurse vetëtimat kurrë nuk janë të rregullta; veç kësaj, ato janë djegëse e shkatërruese. Edhe sikur ta pranojmë se këto pretendime janë të vërteta, si do të shpjegohej rregullimi i marrëdhënies së pretenduar mes rrezeve të diellit, rrezeve ultravjollcë, vetëtimave, nga njëra anë, dhe formimit të qenieve të gjalla, nga ana tjetër?

### Ushqyerja dhe rritja

Si formimi i gjallesës, ashtu dhe ushqyerja e saj na nxjerrin para probleme të veçanta. Qenia e gjallë do të ushqehet, do të zhvillohet, do të sintetizojë lëndë të domosdoshme për veten dhe do ta vazhdojë jetën. Po qe se është shfaqur një qenie e gjallë me anë të evolucionit, siç pretendohet, ajo duhet të jetë ushqyer me mënyrën e difuzionit ngaqë nuk i ka pasur të zhvilluara sistemin e tretjes, të qarkullimit, të frymëmarrjes, pra, në një farë mënyre si ameba. Një mënyrë ushqyerjeje e tillë është e mundur për këto dy shkaqe: dendësia e mjetit dhe e mjedisit. Ndërkaq, rregullimi i ekuilibrit mes dendësisë së proteinës në lëngun ku ndodhet gjallesa dhe dendësisë së lëndëve të ngurta e të lëngshme brenda qelizës së vet është një problem shumë i rëndësishëm.

E dimë se molekulat e shkrira rrjedhin në vende më të lëngshme por nuk futen në vende më të ngurta (viskoze). Ndryshe nga kjo, gjërat që ndodhen në vende më të ngurta, rrjedhin në vende të lëngshme. Ky është një rregull. Kështu, po qe se mjedisi i vargut proteinik të sapoformuar është më i lëngshëm se mjedisi i vet i brendshëm, në proteinë nuk do të hyjë asgjë nga jashtë, përkundrazi, lëndët ushqyese që do të përmbajë proteina, do të rrjedhin jashtë dhe, si rezultat, ekzistenca e kësaj qenieje të gjallë të por-

saformuar do të shkatërrohet. Po qe se mjedisi i jashtëm i vargut proteinik është më i ngurtë se mjedisi i tij i brendshëm, lëndët do të rrjedhin nga jashtë brenda tij duke ia penguar zhvillimin dhe shkatërruar ekzistencën. Edhe në kushtet e të njëjtës gjendje mes dy mjediseve, meqë s'do të ketë difuzion, do të pengohet edhe ushqyerja e gjallesës së re.

Le të themi se, pavarësisht nga të gjitha kushtet e pafavorshme, qenia e gjallë u formua dhe nisi të jetojë. Veç ushqyerjes, ajo do të ketë nevojë të menjëhershme për energji për të hedhur jashtë produktet e katabolizmit. Ku do ta marrë kjo qenie e re këtë energji? Kështu, duhen formuar edhe mitokondritë që vlejnjë si centrale energjitike. Në përgjithësi, qenia e re ka nevojë çdo çast për një sasi energjie të caktuar në mënyrë që të vazhdojë të jetojë.

Sipas llogaritjeve mbi mundësitë, jo vetëm që një substancë kimike (një kombinim kimik) s'mund të kthehet në qenie të gjallë, por edhe formimi i vetvetishëm i një vargu proteinik është i pamundur. Megjithëkëtë, le të pranojmë se gjallesa u formua. Tani ajo nuk do të mbetet në gjendjen e parë, por do të zhvillohet dhe zhvillimi i saj do të kërkojë funksionimin e bashkërenduar të sistemeve të tretjes, qarkullimit, zbrazjes dhe frymëmarrjes që duhet të formohen në çast dhe të fillojnë të funksionojnë me qëllim që gjallesa të jetojë. Mirëpo kjo bie në kundërshtim me konsideratën evolucioniste të Darvinit i cili thotë se një mekanizëm i komplikuar kurrë nuk mund të formohet në një çast.

### **Një tjetër specifikë shumë e rëndësishme që i mashtron darvinistët**

Një tjetër specifikë shumë e rëndësishme që i mashtron darvinistët është se e shohin çështjen ngushtë, vetëm nga dritarja e një apo disa shkencave apo disiplinave shkencore. Mirëpo, në çështjen e gjërave të gjalla e jo të gjalla në gjithësi, veçanërisht në lidhje me botën e gjallë, asnjë shkencë nuk duhet të bjerë në kundërshtim me të tjerat. Fizika, matematika, kimia, botanika, zoologjia,

gjeologjia dhe paleontologjia nuk duhet të bien në kundërshtim me njëra-tjetrën në shpjegimin e sistemit të gjallë. Kështu, në përgjithësi, ne, në lidhje me qenien e gjallë, kur bëjmë kërkime dhe studime në një fushë të caktuar, kërkimet dhe studimet tona nuk i vendosim mbi mutacionin, evolucionin, adaptimin dhe seleksionin natyror. Për shembull, kur punojmë në farmakologji e në profilaksi për të bërë ilaçe të reja, i trajtojmë bakteret që bëhen shkaktarë të sëmundjeve të caktuara si të pandryshueshme dhe mbi këtë bazë i bëjmë ilaçet dhe i përcaktojmë ndikimet e tyre mbi bakteret apo shkaktarët e tjerë. Kur përdorim antibiotikë për mikrobe të caktuara të sëmundjeve të caktuara, nuk e mendojmë fare që, bie fjala, ndërsa kemi dhënë një antibiotik kundër mikrob-it të tuberkulozit, ky, me anë të mutacionit, mund të kthehet në mikrob kolere ose tifoje, etj.! Në profilaksi veprojmë sipas parimit se mikrobet e ruajnë natyrën dhe përmbajtjen e tyre.

Ashtu siç çdo lloj qenie e gjallë e ka mundësinë për t'i zhvilluar mekanizmat e saj të vetëmbrojtjes me qëllim për ta vazhduar jetën, mundësi të cilën ia ka dhënë Allahu, Zoti i gjithësisë, edhe bakteret mund të pësojnë disa ndryshime të brendshme si kundërveprim ndaj ilaçeve që veprojnë mbi to duke ua rritur rezistencën, por kurrë këto ndryshime s'mund të jenë të nivelit të mutacionit që do t'i çonte në një ndryshim lloji. Ndërkaq, s'duhet harruar se po flasim për qenie mikroskopike. Ndryshimi që mund të ndodhë te këto një herë në 30 vjet, te njeriu i korrespondon një ndryshimi që mund të ndodhë në miliarda vjet. Po që se në qenie të tilla nuk ndodh ndonjë ndryshim lloji as në 30 vjet, kjo mjafton për ta kuptuar dhe treguar se mosha e tokës nuk do të mjaftonte për evolucion. Shkenca thotë se algat blu dhe jeshile që rrojnë në dete, kanë ekzistuar edhe 50 milion vjet më parë po në gjendjen që kanë sot!

### **Ekzistenca çift**

Le supozojmë se u formua me anë të evolucionit një shushunjë. Mirëpo ne shohim se jo vetëm në botën e gjallë, por edhe në botën



jo të gjallë, gjërat ekzistojnë me të kundërtat e tyre. Çështje kjo shushunjë dhe ku e ka çiftin e saj? Ata që vizatojnë tipa të sajuar për të përshkruar evoluimin e majmunit në njeri, e tregojnë njeriun me një tip perëndimor në moshë të mesme, por harrojnë të përshkruajnë edhe evoluimin e femrës. Në përgjithësi, evolucionistët nuk tregojnë se si u formua qenia e kundërt në seks (femra) e gjallesës së parë dhe ku u formua, krahas dhe pranë mashkullit, apo diku tjetër. Si e gjetën këta njëri-tjetrin dhe nga e morën “instinktin” e bashkimit seksual. Rastësi do t’u themi të gjitha këtyre? Veçanërisht, a është menduar se sa vjet do të duheshin që qindra mijëra lloje kafshësh të ndërronin lloj e të përhapeshin në shumë vende të botës?

### Qeliza dhe veprimtaria qelizore

Qeliza zotëron një cilësi mbrojtëse më vete. Qeliza funksionon si një shtet. ADN-ja ku është e përcaktuar struktura biologjike e çdo njeriu, është si një sundues, si një komandant. Nga ana tjetër është ARN-ja që vepron si kimist, si inxhinier, që bën sinteza. Kaderi, paracaktimi dhe vlerësimi hyjnor, pothuajse ua ka lënë këtyre caktimin e gjendjes dhe cilësisë së njeriut. Sipas mendimit materialist që nuk gjen dot qendër drejtuese për t’ia dedikuar shifrimin me anë të molekulave të një informacioni sa mijëra vëllime librash, kryerjen e reaksioneve të duhura në kohën e duhur për të sintetizuar proteinat e nevojshme për qelizën, kjo mekanizëm, domethënë deshifrimi nga RNA-ja i shifrave të dërguara nga ADN-ja, është vepër e molekulave dhe rastësive të pavetëdijshme. Edhe pse sot nuk kemi dijeni të sakta për krijimin e parë të qelizës, shkenca moderne na thotë shumë gjëra mbi të. Shkenca na i ka shpalosur para syve pjesët përbërëse të qelizës dhe na ka treguar se ç’qenie komplekse është ajo. Aq komplekse, saqë Darvini, po ta zotëronte atëherë këtë informacion që kemi ne sot për qelizën, fjalët që pati thënë për syrin, do t’i thoshte edhe për qelizën. Në letrën drejtuar një miku, ai shkruan: “Kur e mendoj syrin, më ikën mendja!..” Sepse Darvini nuk e shpjegonte dot syrin me anë të evolucionit.

Po sikur ta shihet dhe njihet edhe trurin, do t'i shtoheshin po aq edhe mahnitja, edhe zemërimi!

Veçoritë e qelizës nuk mbarojnë së numëruari. Brenda saj zhvillohen veprimtari si veprimtaritë e një ushtrie apo të një shteti. Aty sintetizohen gjërat e nevojshme për trupin. Molekulat e vendosura në membranën e saj, të cilat zotërojnë shifra të posaçme, i dallojnë gjërat e dëmshme dhe të dobishme që i vijnë qelizës nga jashtë. Kur paraqitet nevoja, ndodhin shifime të reja. Molekulat e membranës ua hapin portat gjërave të dobishme, kurse ua mbyllin gjërave të dëmshme, ndaj të cilave tregojnë reaksion dhe në qelizë nis një mobilizim i përgjithshëm. Qeliza tregon rezistencë ndaj ndërhyrjeve të jashtme. Po të mos tregojë rezistencë, sëmuret dhe, disa herë, edhe vdes. Kur vdesin një pjesë qelizash, të gjitha qelizat e tjera të trupit bashkëveprojnë për hedhjen jashtë të qelizave të vdekura.

Reaksioni i qelizës ndaj ndërhyrjeve të jashtme tregon se gjëja e hyrë prej jashtë në qelizë nuk e ndryshon identitetin e saj. Jo vetëm kaq, po s'që e tillë që t'i përshtatet strukturës së saj dhe të bëhet e dobishme për të, e prish qelizën, e sëmur dhe e çon gjer në vdekje.

Shkurt, lëreni një gjallesë, por edhe ngjarja më e thjeshtë nuk ndodh dot vetvetiu. Guri nuk lëviz dot vetë nga vendi, nuk hahet ose konsumohet po s'vëpruan faktorë të jashtëm mbi të. Mohimi i Krijuesit dhe i faktit që gjithësinë e ka krijuar dhe e drejton Krijuesi, do të thotë mohim i të gjitha këtyre të vërtetave shkencore. A mund të gjendet shembull dhe argument më i mirë e më kuptimplotë për të treguar se sa i shëmtuar, sa antishkencor, sa anti-logjik është mohimi? Mbetet të themi se njeriu është një qenie e pajisur me mijëra ndjenja dhe me shumë mundësi dhe aftësi të jashtëzakonshme mendore e ndjesore. Veçanërisht, njeriu zotëron vetëdije dhe ndërgjegje. Ai është në marrëdhënie të ngushta edhe me kohën, edhe me hapësirën. Madje, duke mos u kënaqur me kaq, njeriu interesohet për përtej kohës dhe hapësirës.

Veç kësaj, njeriu është një qenie e pajisur me dëshira transcendentale dhe e krijuar për jetën e pasosur. Për rrjedhojë, kushtëzimi i formimit dhe ekzistencës së njeriut nga natyra, rastësia, ligjet konvencionale duke u mbështetur në hipoteza të tilla si evolucioni, është fyerja më e madhe për identitetin e njeriut, për gjithçka njerëzore. Të keqen që ia bën njeriu vetes, nuk mund t'ia bëjë asgjë tjetër. Është për këtë arsye që njerëzit që e kanë përjashtuar veten nga të qenit njeri ose që janë në këtë rrugë, Kurani i ka cilësuar si të këqijtë e vetvetes!

## NJË UDHËTIM I SHKURTËR NË BOTËN E JASHTME DHE BRENDA VETES TONË

Çdo qenie e madhe ose e vogël në gjithësi e vazhdon ekzistencën e saj në një ekuilibër të tillë të hollë e marramendës, saqë është e pamundur ta shohësh këtë gjendje të përgjithshme të përbërë nga margaritarët e urtësisë, përfitimit dhe harmonisë, të mos e mendosh Krijuesin e të mos thuash «Allah»! Në lidhje me këtë, është e mjaftueshme t'i lësh të gjitha të tjerat e të shohësh vetëm brenda vetes tënde. Të gjitha veprimtaritë e trupit tonë paraqesin një sistem të mrekullueshëm të rregulluar me anë të mekanizmave hormonale e nervore shumë të ndjeshme e të lidhura me njëra-tjetrën dhe që funksionon në harmoni. Të gjitha organet, indet dhe qelizat funksionojnë në harmoni dhe përsosmëri pa e cenuar aspak detyrën që u bie sipër, të orientuar sipas një qëllimi dhe përfitimi krejt të qartë dhe duke mos u shkakuar as dëmin më të vogël ndërtimit të trupit, rregullit të tij të përgjithshëm, madje funksionit të një pjese fare të vogël. Meqë edhe ora më e thjeshtë nuk do të mund të mendohej pa artizanin e saj, të mendosh se nuk është dikush që i vë në punë dhe rregullon funksionet jetësore të trupit të njeriut që janë miliona herë më komplekse se të një ore mekanike, që i sheh dhe kontrollon marrëdhëniet mes veprimtarisë dhe rezultateve, duhet të jetë mungesa më e madhe e respektit ndaj të menduarit.

Sidomos ndjeshmëria në qeniet e gjalla, përsosmëria në organet e tyre të shqisave dhe fakti që çdo qenie e gjallë është e pajisur me organet dhe ndjeshmërinë më të përshtatshme për të, të gjitha këto, nëse s'u dedikohen një diturie të patëmetë që di gjithçka dhe që qëndron pas çdo gjëje, një planifikimi të përsosur në kuadër të kësaj diturie dhe një fuqie që e zbaton këtë plan pa asnjë të metë, të gjitha këto, pra, me se mund të shpjegohen tjetër?

Le të prekim nja-dy specifika sa për ta ndriçuar këtë çështje. Po qe se pelikani i pajisur me një sqep të përshtatshëm për të ngrënë peshk, nuk do të ishte i pajisur edhe me këmbë me flatra për të vozitur, ç'do të bënte? A mos vallë do të themi se kjo kafshëz u mendua, u mendua dhe zhvilloi për vete sqepin dhe këmbët e posaçme për notim? Apo mos do t'ia dedikojmë këtë lëndës, materies, natyrës që s'dinë gjë as për pelikanin, as për nevojat e tij, as për ujin dhe peshkun? Apo do t'ia lëmë këtë punë erërave të rastësisë që e tregojnë hapur se, po t'i lihej kjo punë rastësisë, nuk do të kishte as gjithësi bashkë me të gjitha gjërat e mëdha e të vogla që ka brenda? Apo mos do të pretendojmë se e kemi zgjidhur këtë çështje me anë të evolucionit që mbështetet te natyra, lënda dhe rastësia? Zoti im, ç'pretendime të pabaza këto!

Edhe bota bimore me atë gjallëri, harmoni dhe enigmë të mrekullueshme si dhe me atë cilësinë e saj që është përtej të gjitha shkaqeve, thotë "rregull" dhe na ofron mesazhe enigmatike nga një dituri e fshehtë, nga një fuqi e pafundme! Po qe se mundemi të realizojmë një udhëtim ideor në gjithësi duke u nisur nga gjërat e dukura si më të parëndësishme, më të pavlera, kushedi ç'shohim dhe kushedi për ç'gjëra bëhemi dëshmitarë! Edhe kërpudhat e mykut, madje, që rrojnë vetëm mbi kalbësira e dekompozime dhe disa nga llojet e të cilave na e shpëtojnë jetën, kushedi ç'gjëra u pëshpërisin zemrave që ndjejnë dhe mendjeve që mendojnë mbi Sunduesin Absolut që vepron në gjithësi me art, ekonomi, urtësi dhe dituri!

Po të doni, le ta bëjmë një udhëtim të shkurtër edhe në pyjet që pranohen se janë mushkëritë e qyteteve por që, për fat të keq, në ditët tona janë kthyer në të sëmurë rëndë të shtrirë në shtrat! Ta bëjmë një udhëtim të tillë e të shohim solidaritetin mes njerëzve e pemëve, posaçërisht pasurinë biologjike të pyjeve tropikale, marrëdhëniet e shumë llojeve bimësh e kafshësh brenda një nxehtësie magjepsëse dhe se si këto marrëdhënie zhvillohen brenda një harmonie marramendëse!

Në pyjet tropikale, pavarësisht nga kompleksiteti në dukje që

paraqesin mijëra veprimtari të ndërthurura me njëra-tjetrën, ka një rregullsi harmonike të tillë që zemrat e zgjuara e dëgjojnë si një poezi e si një muzikë. Në pyjet tropikale ku reflektohet përsosmëria në artet e Krijuesit të Lartë, nuk shpenzohet kot as dhe gjëja më e vogël; çdo qenie që e plotëson jetëgjatësinë e vet, përpunohet nga qenie të tjera të ngarkuara me atë detyrë, dhe sillet, pas një kohe të shkurtër, në gjendje të përdorshme e të dobishme për pyjet. Pandeh se do të jetë e pamundur që njeriu të arrijë një ditë ta realizojë këtë akord dhe harmoni që vazhdon e tillë qysh prej miliona vitesh, këtë ndarje pune të përsosur, këtë ndihmë reciproke të mrekullueshme të realizuar mes qenieve të gjalla me natyrë krijimi krejt të ndryshme nga njëra-tjetra siç janë bimët dhe kafshët!

Sa për botën e kafshëve, është e qartë se burimi i vërtetë i prirjes së dukurive aq të mrekullueshme sa të mos mund të shpjegohen as me arsye, vetëdije dhe vullnet, është një Dije dhe Vullnet që përfshin tërë ekzistencën, ndryshe, përpjekja për t'i shpjeguar dukuritë e mrekullueshme me një koncept të pakuptueshëm si "instinkti", nuk mund të shkojë më tej se një vetëmashttrim. Fakti që kafshët janë të pajisura me struktura anatomike në përshtatje të plotë me mënyrën e tyre të jetesës, fakti që shumë kafshë, si zogjtë, merimangat, karkalecat, etj. janë marrë nga njeriu si modele në teknikë dhe teknologji dhe, si të tilla, i kanë siguruar njeriut suksese të mëdha e të jashtëzakonshme, janë nga një mrekulli më vete që edhe në mos i bëfshin dot evolucionistët, për egoizëm, ta pranojnë se e kanë gabim, janë në gjendje t'i shtrëngojnë në një skaj pa dalje për t'i bërë që ta mbyllin gojën!

Udhëtimin tonë mund ta vazhdojmë edhe në botën e sëmundjeve, shëndetit, ilaçeve, mjekimit, imunitetit, mikrobeve. Në të vërtetë, edhe ato qenie mikroskopike që ne u themi "mikrobe" e që i luftojmë me antibiotikë dhe ilaçe të tjera, janë krijuar në dobi të njeriut dhe gjallesave të tjera dhe për një ekuilibër. Po, këto gjallesa mikroskopike që s'i shohim dot me sy, vrapojnë në ndihmë të njeriut. Ç'ë do se këto mikrokrijesa që në vendin e vet janë shumë të dobishme, për shkak të mjeteve dhe mjedisve të këqija të për-

gatitura prej nesh, bëhen shumë të dëmshme. Kur mendojmë për sistemin imunitar si mekanizmi më kompleks dhe i fshehtë i trupit tonë, na rritet shpresa se në të ardhmen do të bëhen të shërueshme edhe sëmundje që sot duken si të pashërueshme.

Mendimi materialist i cili mban në themelin e vet zhurmë, di-alektikë dhe mohim të Zotit, pavarësisht nga të gjitha këto e plot të tjera të vërteta krejt të hapura, jep konkluzione apriori duke mohuar çdo gjë tjetër veç materies dhe paraqet një entitet krejt dogmatist.

Teoritë e materialistëve mbi ekzistencën dhe jetën që kanë gënjyer dhe mashtruar shumë njerëz gjer më sot, janë hulumtuar e kontrolluar pikë për pikë nga shumë e shumë mendimtarë, janë kritikuar me rrugë e metoda të ndryshme dhe, në përfundim është kuptuar se as pretendimet që ia kanë ofruar botës shkencore duke i përzierë në mënyrë artizanale ato (pretendime) në shkencat eksperimentale, as dhe teoritë e tyre mbi jetën që i kanë parashtruar duke i popullarizuar me një zhurmë të madhe propagandistike, nuk janë aspak të shëndosha ashtu siç pandehet. Sot, në ditët tona, më në fund, është kuptuar se e tërë ekzistenca ndodhet e lidhur pas një sërë ligjesh si vepër e një fuqie eternale tejet të lartë dhe mbi çdo gjë tjetër. Po qe se e ilustrojmë këtë me një specifikë që e njohim mirë të gjithë, ndërsa lënda dhe materia në trupin tonë janë në ndryshim të vazhdueshëm, identiteti ynë nuk pëson asnjë ndryshim!

Në të vërtetë, sot, të gjitha zbulimet dhe konkluzionet të arritura dhe parashtruara nga shkencat e natyrës dhe teknika, kanë treguar se nuk është e vërtetë se kudo është një materie që vëzhgon dhe vepron, siç pretendojnë materialistët, se çdo gjë s'është identitet i ndryshimeve periodike materie-energji dhe energji-materie, se krijimi dhe ekzistenca e qenies është aq e komplikuar sa kurrë nuk mund të shpjegohet me anë të rastësive. Kështu, kalbëzimi në themel i pikëpamjes materialiste të konsideruar gjer më sot si e përsosur dhe e pakundërshtueshme, është provuar edhe një herë tjetër!

## KRIJIMI NË KURAN DHE NË HADITHET PROFETIKE

### Karakter i mrekullor i Kuranit

Para se të parashtroj ajetet kuranore lidhur me krijimin, dëshiroj të prek disa ajete të caktuara për të treguar se ç'karakter mrekullor ka Kurani. Deklarata-mrekulli Kuran është ajo që e thotë fjalën e fundit, ajo që u vë vulën gjërave!

1. *“Edhe te kafshët ka mësim për ju. Nga gjëja që kanë në barkun e tyre, Ne ju japim të pini qumësht të pastër e të shijshëm të kulluar mes ushqimit dhe gjakut...”* (Nahl, 66)

Një nga shenjat dhe provat që argumentojnë ekzistencën dhe unitetin e Allahut, janë kafshët e qumështit. Qumështin e shijshëm e të ushqyeshëm që e pimë ne, Allahu e nxjerr nga tretësira ushqimore në zorrët e kafshëve (që konsiderohet si jashtëqitje meqë pas thithjes së lëndëve ushqimore prej saj, del jashtë si feçe) pas kullimit në gjak. Shkenca e sotme e ka bërë të qartë se në fillim lëndët ushqimore thithen nga qimet thithëse të zorrëve dhe kalojnë në gjak, nga i cili, në indet e tjera lëshohen si ushqim, kurse në gjëndrat e qumështit, kthehen në qumësht. Me shprehjen *“min bejni fersin ve demin”*, *“prej mes feçeve dhe gjakut”*, në Kuran tregohet se qumështi kalon dy procese filtrimi: i pari, nga feçet (lënda ushqimore e tretur në zorrë) në gjak dhe, i dyti, nga gjaku në qumësht. Profeti Muhamed, i cili e lajmëronte një gjë të tillë 14 shekuj më parë, pa dyshim që personalisht nuk mund t'i dinte këto gjëra. Ato ia kishte mësuar Allahu me anë të Kuranit!

2. *“Atij që dëshiron ta udhëzojë, Allahu ia zgjeron zemrën ndaj Islamit, kurse atij që dëshiron ta lërë të humbur, ia shtrëngon gjoksin sikur të ishte duke u ngjitur në qiell...”* (En'am, 125)



A e dini se kujt i përngjet gjendja e njeriut që nuk beson? Atij që ngjitet në lartësi ku oksigjeni rrallohet aq sa ta bëjë gjithnjë e më shumë të pamundur frymëmarrjen gjer në vdekje. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së oksigjenit, personi ndjen shtrëngim në gjoks. Sa më lart të ngjitet njeriu, aq më i rrallë bëhet oksigjeni dhe aq më e fortë dhimbja në gjoks. Këtu kemi një paralelizëm figurativ të mbështetur në një fakt shkencor të njohur shumë shumë vonë, por të paralajmëruar nga Kurani 14 shekuj më parë!

3. *“Ne i lëshojmë erërat mbarështuese dhe nga qielli lëshojmë shi për ju...”* (Hixhr, 22)

Disa komentues të vjetër nuk e kanë kuptuar si duhet cilësimin e erërave si mbarështuese. Kurse kur e kanë pyetur Ibni Abasin 11 shekuj më parë mbi kuptimin e këtij ajeti, ka thënë: “Erërat bëjnë mbarështimin e bimëve, pastaj edhe të reve...”<sup>2</sup> Megjithëkëtë, edhe komentuesit pas tij nuk e kanë kuptuar dot rolin mbarështues të erës për retë. Siç dihet, retë ngarkohen me elektricitet duke lëvizur e duke u fërkuar me ajrin, gjë të cilën ua siguron era. Ndërkaq, duhet theksuar se si tek mbarështimi i bimëve, ashtu dhe te i reve, kemi dukurinë e bashkimit të gjërave çift ose me ngarkesa të kundërta. Në lidhje me këtë, në ajete të tjerë Kurani bën fjalë mbi krijimin çift (Jasin, 36; Dharijat, 49). Dhe kjo është një mrekulli tjetër e Kuranit.

4. *“Shihni se si i shtyn Allahu retë, pastaj i bashkon, i bën grumbull dhe ju shihni se si rrjedh prej tyre shi. Ai lëshon nga retë e mëdha si kodra edhe breshër, me të cilin godet kë të dojë e nga i cili mbron kë të dojë. Shkëlqimi i dritës së vetëtimës sa s’ të merr sytë!”* (Nur, 43)

Qysh atëherë kur nuk njihej fare përbërja e reve, Kurani bënte përshkrime të sakta që u zbuluan vetë 14 shekuj më vonë.

5. *“Ne e ngritëm qiellin me dorën tonë dhe Ne e zgjerojmë atë pa pushim.”* (Dharijat, 47)

Në vitet 1920, Hubble i bëri një dhuratë botës astronomike. Me

<sup>2</sup> Taberi, Xhamiul Bejan, vëll. 14, f. 19-22.

anë të një gjetjeje matematike që u quajt me emrin e tij, Koeficienti i Hubbles, ai zbuloi se disa galaktika largoheshin pa pushim prej nesh. Më pas, matematikani belgjian, Lamaitre e përcakttoi këtë dukuri si “zgjerim i hapësirës”. Pastaj kjo dukuri u pranua edhe nga shkencëtarë të tjerë si dhe nga Ajnshtajni.

## E vërteta e krijimit në Kuran

Nga ajetet kuranore në lidhje me krijimin, do të shqyrtojmë katër prej tyre.

1. *“Dhe i thamë: ‘O Adem, ti dhe bashkëshortja jote banoni në xhenet dhe hani sa të doni nga të mirat që ka atje, vetëm atë pemë mos e prekni se, ndryshe, do të bëheni dhunues e të padrejtë.’”* (Bakara, 35)

Kurani e fillon rrëfimin mbi krijimin njerëzor me njeriun e parë dhe bashkëshorten e tij dhe nuk bën fjalë aspak për evolucionin.

2. *“Për Allahun, gjendja e Isait është si gjendja e Ademit. Allahu e krijoi Ademin prej dheu. Ai i tha Ademit ‘bëhu’ dhe ai u bë!”* (Al-i Imran, 59)

Kur njerëzit ranë në dyshim në lidhje me krijimin e Profetit Isa (Jezusit) dhe nisën të gjykojnë se si mund të lindte njeriu pa baba, iu erdhi në ndihmë Kurani që sqaronte se në lindjen e tij pa baba nuk kishte gjë për t’u çuditur, pasi lindja e tij ishte një mrekulli si dhe krijimi i Ademit, ndërkaq që ky s’kishte patur as nënë. Kjo do të thotë se Allahu ka mundësi për çdo gjë dhe bën gjithçka që dëshiron. Ndërkaq, me qëllim që ne ta kuptojmë veprimtarinë e Tij, Allahu e mbulon atë me anë të shkaqeve dhe pasojave që janë të kuptueshme për ne dhe na duken të natyrshme e të zakonshme. Kurse disa herë Allahu e heq mbulesën e shkaqeve me qëllime dhe urtësi të caktuara dhe, atëherë, aktet e tij na duken të jashtëzakonshme e të pashpjegueshme, prandaj i quajmë mrekulli. Kështu, edhe krijimi i Ademit, edhe krijimi i Isait janë sa të mundshme për Allahun, aq dhe të pamundshme për ne kur i gjykojmë ato

në kuadrin e shkaqeve dhe pasojave dhe me kriteret me të cilat gjykojmë ngjarjet e tjera të ashtuquajtura të zakonshme.

3. *“Dhe u tha Zotit yt engjëjve: “Unë krijova një njeri prej balte dhe i fryva nga fryma ime, prandaj bini në gjunjë para tij...”* (Hixhr, 28-29)

Këto ajete tregojnë se njeriu i parë, Ademi, u krijua prej dheu dhe atij iu dha frymë hyjnore. Sot dihet se njeriu formohet në mitërën amësores nga zhvillimi në etapa të caktuara i vezës së fekonduar nga spermatozoidi, pra, duke pasur për bazë një koncentrat dhe jo me anë të ndonjë farë evolucioni. Sipas përshkrimit të Kuranit, edhe njeriu i parë pati për bazë një koncentrat të përbërë nga elementët e tokës dhe uji, i cili u zhvillua në kushte të caktuara që cilësohen si urdhri “bëhu” i Zotit. Mes bazës dhe krijimit të njeriut të parë dhe njeriut të zakonshëm sot nuk ka asnjë ndryshim. Koncentrati është po ai, kurse mjedisi i krijimit, ndërsa për njeriun e sotëm është mitra, për njeriun e parë është përsëri një “mitër”, por e panjohur për ne, e cilësuar vetëm si urdhri “bëhu” i Zotit dhe fryma hyjnore. Në të dy llojet e krijimit nuk ka asgjë të përbashkët me evolucionin.

4. *“O njerëz! Ruhuni prej Zotit tuaj që ju krijoi juve prej një fryme të vetme, që krijoi për ju shoqe nga vetja juaj dhe nga dy të parët krijoi meshkuj e femra!”* (Nisa, 1)

Duke e quajtur atin e parë të të gjithë njerëzve, “një frymë të vetme”, Kurani kundërshton dhe hedh poshtë vargun e etërve të njeriut që pretendon evolucionin. Sipas Kuranit, njeriu i parë bart dhe përfaqëson “frymën e vetme”, nga e cila, pastaj u krijua çifti i parë dhe prej të dyve, gjithë njerëzimi. Kështu, as “fryma e vetme”, as dhe çifti i vet që bartte të njëjtin entitet njerëzor, nuk ishin hallkë e një zinxhiri evolucioni. Njeriu ose fryma e parë është ati i një lloji qeniesh më vete, po ashtu, çifti i tij, nëna e po atij lloji qeniesh më vete!

## Kuptimi i disa ajeteve të tjera kuranore që kanë lidhje me krijimin

\* *Betohem se Ne e krijuam njeriun prej një esence prej balte.* (Muminun, 12)

\* *Ne, çdo gjë të gjallë e krijuam prej uji.* (Enbija, 30)

\* *Dhe Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri prej balte dhe, pasi t’i jap formë e t’i fryj prej frymës sime, ju bini në gjunjë para tij!” Të gjithë engjëjt ranë në gjunjë para tij, kurse Iblisi, djalli, jo! Ai u mbajt më të madh e u bë mohues! (Sad, 71-74)*

\* *Ai është që e krijoi njeriun prej një pike uji dhe e bëri fis të lidhur me lidhje martese. Zoti yt ka mundësi për gjithçka!* (Furkan, 25:54)

\* *Allahu ju krijoi ju prej dheu, pastaj prej uji. Pastaj ju bëri çift.* (Fatir, 11)

\* *Ai është që ju krijoi ju prej një balte dhe që pastaj ju caktoi një jetëgjatësi dhe vdekje. Gjithashtu, te Ai ka një vendim të parashkruar. Akoma po dyshoni?* (En’am, 2)

\* *Ai është që ju bëri ju prej një fryme të vetme. Pastaj për ju ka një vend ku të rrini dhe, si amanet, një vend për të qëndruar. Ne i bëmë të ditura ajetet tona hapur për ata që kuptojnë.* (En’am, 98)

\* *Allahu që e ka krijuar çdo gjë të bukur dhe të përsosur, krijimin e njeriut e nisi nga balta. Pastaj, brezin e tij e riprodhoi prej një esence uji (spermë). Pastaj i dha atij formën më të bukur, i fryu nga fryma e vet dhe krijoi për ju veshë, sy dhe zemra. Por sa pak që falenderoni!* (Sexhde, 7-9)

\* *Allahu e krijoi njeriun nga argjila e pjekur.* (Rahman, 14)

### Krijimi në hadithet profetike

1. Buhariu dhe Muslimi përcjellin njëzëri prej Ebu Hurejres se në një pjesë të një hadithi të gjatë ku tregonte për krijimin e gruas,

Profeti ka thënë: “Këshillojini gratë për të mirë dhe silluni mirë me to. Ato janë krijuar prej një brinje!”<sup>3</sup>

Siç duket hapur nga hadithi, Profeti nuk e lidh krijimin e gruas me evolucionin.<sup>4</sup>

2. Në një hadith tjetër të quajtur autentik nga Ibn Ebi Hatimi dhe të përcjellë nga Ibni Asakiri me pak ndryshime, Profeti thotë kështu: “Ati juaj, Ademi, e kishte shtatin si një dru hurmaje, 60 pash të gjatë.”<sup>5</sup>

I Dërguari i Allahut e paraqet Ademin si atin e parë të njerëzimit në një mënyrë aq të qartë e të prerë, sa s’lë vend për interpretim.

3. Ahmed b. Hanbel, Ebu Davud dhe Tirmidhi përcjellin këtë hadith prej Ebu Musa el-Esh’ariut: “Allahu mori prej gjithë faqes së tokës një grusht dhé dhe e krijoi Ademin.”<sup>6</sup>

Edhe nga ky hadith kuptohet se baza e Ademit është një koncentrat i tërë dherave të tokës. Allahu e ka krijuar atë nga sinteza e këtij koncentratit.

4. Në një hadith tjetër të përcjellë nga Ahmed b. Hanbel prej Enesit thuhet: “Pasi e krijoi Ademin, Allahu e la për një farë kohe aq sa deshi. Iblisi e shihte Ademin dhe filloi të thurë iluzione rreth tij. Dhe kur e pa bosh, e kuptoi se nuk do të bëhej një krijesë zotëruese e vetvetes.”<sup>7</sup>

5. Ibn Hibban dhe Bezzari, autori i një Musnedi, përcjellin këtë

<sup>3</sup> Buhari, Enbija, 1; Muslim, Rada, 61-62; Darimi, Nikah, 35; Musned, 5/88.

<sup>4</sup> Për kuptimin e krijimit të Hz. Havasë prej brinjës së Hz. Ademit, shih F.Gylen, Lëkundjet që solli shekulli, përkthimi shqip.

<sup>5</sup> Ibni Asakir, Tarihi Dimeshk, 7/404-405. Veçanërisht shih Buhari, Istizam, 1. Në një periudhë kur sipërfaqja e tokës ishte e mbuluar me pyje dhe kur nuk ishte formuar ende popullsia njerëzore, është normale që shtati i njeriut të ketë qenë i tillë. Në gjatësinë e shtatit të njeriut ndikojnë si klima dhe kushtet e sipërfaqes, ashtu dhe dendësia e popullsisë, e cila shkakton shkurtimin e shtatit. Ndërkaq, për ta mbajtur të gjerë kuadrin e kuptimit të çështjes, është mirë të mbahet parasysh edhe interpretimi i Ibni Haldunit, i cili thotë se Ademi mund të ketë pasur këtë shtat kur ka qenë në xhennet. Allahu e di se çështë më e drejtë! 2. Njësia e gjatësisë së pashit merret sa gjatësia e parakrahut (rreth 40 cm.).

<sup>6</sup> Tirmidhi, Tefsiru sure, 1-2; Ebu Davud, Sunnet, 16; Musned, 4/400-406.

<sup>7</sup> Musned, 3/152.

hadith nga Enesi: “Kur Allahu i fryu Ademit nga fryma e tij, Ademi teshtiu dhe tha pas teshtitjes, “Elhamdulillah Rabbilalemin!”, “Lavdi Allahut, Zotit të botëve!” Kurse Allahu ia ktheu: “Jerhamukallah”, “Allahu të dhëntë shëndet!”<sup>8</sup>

Te Buhariu lexojmë këtë rivajet: “Allahu i Lartë e krijoi Ademin sipas fytyrës së Tij (si qendër të shfaqjes së të gjithë emrave të Tij) dhe me shtat 60 pash...”<sup>9</sup>

6. Ahmed b. Hanbel përcjell këtë hadith prej Ebu Hurejres: “Njerëzit do të hyjnë në Xhenet në gjendjen e Ademit kur u krijua. Ai ishte lakuriq, pa qime, i ri, lëkurëbardhë, me sy të shkruar, me shtatin 60 pash dhe gjerësinë e shpatullave 7 pash.”<sup>10</sup>

### Krijimi në Librin e Shenjtë

Le të flasim dy fjalë edhe për kapitullin mbi gjenezën te Dhiata e Vjetër. “Zoti e krijoi Ademin prej baltës së tokës, i fryu në hundë dhe ai u bë njeri i gjallë.”<sup>11</sup> Kurse krijimi i Havasë përshkruhet kështu: “Dhe Zoti i dha Ademit një gjumë të thellë, pastaj i mori një brinjë dhe ia mbushi vendin me mish. Pastaj prej asaj brinje bëri një grua dhe ia solli Ademit!”<sup>12</sup>

Si Kurani, edhe Libri i Shenjtë dhe të gjithë librat e tjerë hyjnorë bëjnë të ditur se njeriu i parë është krijuar nga Zoti prej elementëve të dheut dhe kështu besojnë të gjithë anëtarët e feve. Pra, sështë ashtu siç thonë Darvini dhe evolucionistët. Njeriu nuk e ka marrë formën e sotme duke evoluar.

<sup>8</sup> Hejsemi, Mevaridu’z-Zem’an, I/508; Ibn Hibban, Sahih, 14/37, 41.

<sup>9</sup> Buhari, Isti’zan, 1; Enbija, 1; Muslim, Xhennet, 28; Tirmidhi, Tefsiru’l-Kuran, 94; Mustedrek, 1/132.

<sup>10</sup> Musned, 2/295, 343, 415.

<sup>11</sup> Gjenezë, 2:7.

<sup>12</sup> Gjenezë, 2:18, 21-22.

## PËRFUNDIM

E vërteta që u përpoqa ta parashtroj nga kreu gjer këtu, është kjo:

Sado me kujdes që të ketë qarkulluar teoria e evolucionit dhe sot e që mund të qarkullojë nesër në disa katedra shkencore, në librat e disa shkencëtarëve e në gojët e tyre, nuk ka një bazë të shëndoshë, nuk ka një argument bindës që të mund ta mbështesë evolucionin. Nuk janë gjetur dot fosile që ta lidhin njeriun me majmunin. Në disa fosile janë bërë falsifikime, disa të tjera i kanë formuar duke i mbledhur pjesët andej-këtej dhe pjesët e mangëta i kanë montuar sipas imagjinatës. Gjenetika e kundërshton këtë!

Struktura e ADN-së që kërkon dituri dhe fuqi të jashtëzakonshme, i lë krejtësisht jashtë mundësie të gjitha llojet e rastësive dhe ndërhyrjeve të pavetëdijshme. Gjërat e pretenduara gjer tani si argumente, ose janë hipoteza, ose interpretime të sforcuara dhe të gjitha boshllëqet teorike janë mbushur e mbushen me skenarë të fantazuara. Kurse pretendimet e mbrojtura duke u nisur nga një sërë ngjashmëri, janë vlerësime që i japin prioritet strukturës pa parë funksionet dhe detyrat jetësore dhe asnjëri prej tyre s'vlen si argument.

Momenti vital i çështjes është se ata që thonë “i gjetëm”, ata që i parashtrojnë “gjetjet” si argumente, janë mjediset që i besojnë plotësisht evolucionit, kurse të gjitha të ashtuquajturat argumente të tyre kanë nevojë për shqyrtim. Ashtu si rastësitë nuk kanë as vendin më të vogël në ekzistencë, në të njëjtën mënyrë, është e pamundur që një qenie e gjallë të ekzistojë vetvetiu nga hiçi. Ashtu si eksperimentet e Pastërit, edhe eksperimentet më të gjera, më të thella të bëra rreth kësaj çështjeje, e hedhin poshtë krijimin

(ekzistencën) vetvetiu. Edhe nëse te një qenie e gjallë ndodhin disa ndryshime të pjesshme për shkak të disa kushteve të caktuara, këto ndryshime jo vetëm që s'mund të bëhen kurrë bazë për ndryshim lloji, jo vetëm që një ndodhi e tillë nuk është hasur gjer më sot, por ato kanë ndodhur sepse e ka lejuar përbërja e asaj qenieje. Edhe faktorë të tillë si struktura e gjallesave, kromozomet, imuniteti i qelizës dhe kundërshtimi i ndërhyrjeve nga jashtë, në fakt, në asnjë mënyrë s'i hapin portë mundësisë së shndërrimit të llojit. Veç kësaj, të gjitha fetë e kaluara, të gjithë profetët, të gjithë librat e shenjtë e shprehin hapur se çdo gjë, përfshi edhe njeriun, është krijuar nga Zoti (Allahu) duke ia mbyllur të gjitha dyert evolucionit!

Jo vetëm që kjo çështje nuk është fusha ime, por dhe unë u përpoqa ta shpjegoj një çështje që shpesh mund të shpjegohet në mënyrë të shumanshme e të thellë, vetëm në vijat e saj kryesore dhe bashkë me disa specifika që shpëtojnë nga shikimi. Duke u justifikuar me dobësinë dhe paaftësinë time, megjithatë, duke e theksuar rëndësinë e çështjes, i lutem Zotit që dijetarët e zellshëm e të lidhur pas të vërtetës ta kryejnë detyrën që u takon për ta shqyrtuar këtë çështje gjerë e gjatë dhe për ta shpëtuar brezin e ri nga mashtrimi me anë të dogmës së evolucionit që mbahet në rend të ditës në emër të mohimit të hyjnitetit. Unë mendoj se ka ardhur e ka kaluar koha që, në vend të librave të shkruar në Perëndim dhe nga ana e mjediseve përkrahëse të evolucionit, të shkruhen libra që mbështeten te e vërteta dhe thonë të vërtetën!